



# Manual

## Për Monitorimin e Medias nga Misionet e Vëzhgimit të Zgjedhjeve

Botuar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike  
dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR)  
Ul.Miodowa10, 00-251 Varshavë, Poloni  
[www.osce.org/odihr](http://www.osce.org/odihr)

© OSCE/ODIHR 2018

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret dhe të kopjohet lirisht për qëllime edukative dhe jokomerciale, me kusht që një riprodhim i tillë të shoqërohet me një shënim ku të thuhet se burimi është OSBE/ODIHR-i.

ISBN 978-92-9234-986-8

Fotografia e kopertinës nga OSBE

Dizajni nga Nona Reuter

Shtypur në Poloni nga Centrum Poligrafii Sp. z o.o

# **Manual**

Për Monitorimin e Medias nga  
Misionet e Vëzhgimit të Zgjedhjeve



# PASQYRA E LËNDËS

<b>Parathënie</b>	<b>7</b>
<b>1. Hyrje</b>	<b>9</b>
<b>2. Media në procesin zgjedhor</b>	<b>13</b>
A. Të drejtat e zgjedhësve	13
B. Të drejtat e kandidatëve dhe partive	14
C. Liria e medias	14
<b>2.1 Llojet e mediave dhe mbulimi i zgjedhjeve</b>	<b>14</b>
A. Media elektronike	15
B. Media e shkruar	16
C. Interneti dhe mediat e tjera të reja: një këndvështrim i përgjithshëm	17
<b>3. Monitorimi i medias nga misionet e vëzhgimit të zgjedhjeve: vështrim i përgjithshëm</b>	<b>19</b>
<b>3.1 Detyrat e analistit të medias</b>	<b>19</b>
<b>3.2 Roli i analistit të medias në misionet e vëzhgimit të zgjedhjeve</b>	<b>19</b>
3.2.1 Njësia e medias	20
<b>3.3 Analizimi i medias: Çfarë përpiqemi të vlerësojmë?</b>	<b>21</b>
<b>4. Udhëzime për monitorimin e medias: çështjet e ndjeshme, standardet bazë dhe praktikat e mira</b>	<b>25</b>
<b>4.1 Kuadri ligjor, rregulloret për zgjedhjet, administrimi i zgjedhjeve dhe organet rregullatore të medias</b>	<b>26</b>
<b>4.2 Peizazhi mediatik dhe roli i autoriteteve</b>	<b>28</b>
<b>4.3 Mbulimi nga media</b>	<b>28</b>
A. Pluralizmi dhe rregullimi ligjor	28
B. Avantazhi i kandidatëve dhe partive në pushtet	28
<b>4.4 Rregullimi i mbulimit nga media gjatë zgjedhjeve</b>	<b>29</b>
<b>5. Kryerja e monitorimit të medias</b>	<b>35</b>
<b>5.1 Vlerësimi i rolit dhe performancës së medias gjatë zgjedhjeve</b>	<b>35</b>
5.1.1 Studimi i kuadrit ligjor	35
5.1.2 Vëzhgimi i peizazhit mediatik	36
5.1.3 Monitorimi i mbulimit mediatik të fushatave zgjedhore	38
5.1.4 Monitorimi i ankesave që lidhen me median dhe i shkeljeve të lirisë së shprehjes	44

<b>6. Përpunimi dhe analizimi i të dhënave</b>	<b>47</b>
6.1 Njësitë e kontekstit	47
6.2 Njësitë e regjistrimit	47
6.3 Kodimi	47
6.4 Sistemi i matjes	49
6.5 Cilësia e mbulimit	49
6.6 Peshimi i rasteve	50
6.7 Interpretimi i të dhënave	51
<b>SHTOJCË: Përmbledhje e standardeve dhe parimeve për lirinë e shprehjes gjatë zgjedhjeve</b>	<b>53</b>

# PARATHËNIE

Liria e shprehjes dhe liria e medias janë thelbësore për çdo proces demokratik dhe vlerësimi i mbulimit të fushatave zgjedhore nga media përbën një pjesë themelore të metodologjisë së vëzhgimit të zgjedhjeve. Ky botim ofron një shpjegim të përmbledhur të metodologjisë së monitorimit të medias që përdoret nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) në veprimtaritë e saj për vëzhgimin e zgjedhjeve.

Ky manual përfshin një sërë udhëzimesh për mbulimin e fushatave zgjedhore nga organet e mediave publike dhe private, sidomos nga mediat e shkruara dhe ato elektronike, por trajton, gjithashtu, edhe mediat që lidhen me internetin dhe mediat e tjera të reja. Manuali nuk ka për qëllim të ofrojë një katalog të hollësishëm të këtyre çështjeve, por të theksojë disa parime të përbashkëta, që janë të rëndësishme për vëzhguesit ndërkombëtarë në vlerësimin e proceseve zgjedhore nga këndvështrimi i medias.

Pjesa e fundit e këtij botimi përfshin disa informacione bazë mbi aspektet teknike të monitorimit të medias, duke shpjeguar rolin e veçantë të analistit të medias në misionet e vëzhgimit të zgjedhjeve (MVZ-të). Megjithatë, ai nuk është konceptuar si një manual teknik, që përshkruan me hollësi çdo aspekt të kësaj detyre.





# Hyrje

Në leximin e këtij manuali, ka dy pika të rëndësishme dhe të lidhura me njëra-tjetrën, që duhen kuptuar që në fillim. E para është që shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së i kanë dhënë ODIHR-it, mandatin e zhvillimit të vëzhgimit afatgjatë të të gjitha aspekteve të procesit zgjedhor, që nga regjistrimi i zgjedhësve dhe kandidatëve, gjithë ditën e zgjedhjeve e deri tek ardhja në pushtet e zyrtarëve të zgjedhur. Ky mandat i referohet në mënyrë specifike nevojës për të vlerësuar funksionimin e medias, e cila çon në pikën e dytë: Media luan rol thelbësor në çdo zgjedhje. Për këtë arsye, kuptohet që çdo përpjekje për vëzhgimin e zgjedhjeve duhet t'i kushtojë vëmendje të konsiderueshme veprimtarisë së medias dhe mbulimit prej saj të zgjedhjeve.

Në Samitin e OSBE-së, të vitit 1994, në Budapest, shtetet pjesëmarrëse pranuan qartë rëndësinë e medias dhe i dhanë ODIHR-it mandatin "për të luajtur një rol më të madh në monitorimin e zgjedhjeve para, gjatë dhe pas ditës së zgjedhjeve. Në këtë kontekst, ODIHR-i duhet të vlerësojë kushtet për funksionimin e lirë dhe të pavarur të medias."

Gjatë zgjedhjeve, media ofron një kanal të paçmueshëm informimi mes kandidatëve dhe publikut. Duke ofruar një arenë për debat publik dhe duke informuar qytetarët rreth politikave dhe platformave të kandidatëve dhe partive, media u jep mundësi zgjedhësve të jenë të mirinformuar para se të vendosin se për kë të votojnë. Rëndësia e kësaj pike të fundit nuk mund të jetë e ekzagjeruar, pasi mundësia e zgjedhësve për të zgjedhur, duke qenë të mirinformuar, është një nga aspektet kyçe të zgjedhjeve demokratike.

Shumë hapa janë ndërmarrë për të garantuar funksionimin e medias në mënyrë të ndershme, objektive dhe të ekuilibruar në përmbushjen e funksionit të saj, në çdo shoqëri demokratike. Kjo përfshin miratimin e marrëveshjeve të shumta ndërqeveritare për lirinë e medias dhe të shprehjes; rekomandimet nga organizata ndërkombëtare dhe rajonale; ligjet kombëtare për funksionimin e medias; krijimin e transmetuesve të shërbimit publik; ngritjen e organeve rregullatore kombëtare për median dhe marrjen e masave vetërrgulluese nga organizatat e medias.

Shumë prej shteteve që janë pjesë e OSBE-së, janë i nënshtrohen angazhimeve që kanë ndërmarrë në kuadrin e institucioneve të tjera dhe orientohen, sigurisht, nga legjislacioni i tyre vendas. Të gjitha shtetet e OSBE-së kanë rënë dakord edhe me një sërë angazhimesh specifike të OSBE-së, që lidhen me çështje të rëndësishme si liria e shprehjes, liria e medias dhe zhvillimi i zgjedhjeve demokratike.

Dispozitat kryesore të këtyre angazhimeve mund të përmbliidhen, si më poshtë:

- ✎ Liria e medias është një nga kushtet bazë për një shoqëri pluraliste dhe demokratike;
- ✎ E drejta e lirisë së shprehjes është një e drejtë themelore e njeriut dhe një kusht i domosdoshëm në sistemet demokratike. Për këtë arsye, të pasurit e medias autonome dhe pluraliste është thelbësore për një shoqëri të hapur dhe të lirë dhe për ofrimin e informacionit të nevojshëm për t'i vënë para përgjegjësisë personat në pushtet;
- ✎ Media e pavarur dhe e lirë është veçanërisht e rëndësishme për garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
- ✎ Zbatimi i angazhimeve të OSBE-së në lidhje me mediat duhet të forcohet për të garantuar një sferë vërtet të hapur informimi;
- ✎ Liria e shprehjes, duke përfshirë këtu edhe të drejtën e komunikimit dhe të drejtën e medias për të mbledhur dhe për të përhapur informacione dhe opinione, është një e drejtë themelore e njeriut;
- ✎ Publiku duhet të gëzojë të drejtën e lirisë për të marrë dhe për të dhënë informacione dhe ide, duke përfshirë këtu edhe përmes publikimeve të huaja dhe transkriptimeve të huaja, pa ndërhyrje nga autoritetet publike;
- ✎ Media duhet të gëzojë akses të pakufizuar në lajmet e huaja dhe shërbimet e informacionit;
- ✎ Çdo kufizim i së drejtës së lirisë së shprehjes duhet parashikuar në përputhje me standardet ndërkombëtare. Çdo kufizim i lirisë së shprehjes duhet të respektojë tre parime kryesore:
  - ◆ **Ligjshmërinë:** Çdo kufizim i lirisë së shprehjes duhet të përkufizohet me ligj;
  - ◆ **Ligjshmërinë:** Qëllimet legjitime të kufizimeve të tilla përfshijnë sigurimin e respektimit të të drejtave dhe lirive të tjerëve, parandalimin e trazirave apo krimeve, si dhe mbrojtjen e shëndetit apo moralit publik;
  - ◆ **Proporcionalitetin:** Çdo dispozitë që nënkupton kufizime të së drejtës së lirisë së shprehjes duhet të jetë në përpjesëtim me qëllimet, për të cilat vendosen këto kufizime;
- ✎ Sulmet apo ngacmimet ndaj gazetarëve duhet të dënohen dhe personat përgjegjës duhet të vendosen përpara përgjegjësisë;
- ✎ Duhet të merren masa për mbrojtjen e gazetarëve të përfshirë në veprimtari profesionale të rrezikshme;

- ☞ Të drejtat për pjesëmarrje të individëve apo grupeve përfshijnë të drejtën e tyre për të pasur akses të pakufizuar në media, mbi baza jodiskriminuese; dhe
- ☞ Asnjë pengesë ligjore apo administrative nuk duhet të pengojë aksesin në media gjatë procesit zgjedhor.

Periudhat zgjedhore përbëjnë një impenjim të veçantë për profesionistët e medias. Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias i ndjek zhvillimet në këtë fushë të medias në shtetet pjesëmarrëse dhe nxit përmbushjen e plotë të angazhimeve të OSBE-së në lidhje me lirinë e shprehjes dhe median e lirë. Në deklaratat periodike të Përfaqësuesit janë theksuar vazhdimisht këto pika:

- ☞ Një media e lirë dhe një gjyqësor i pavarur dhe i efektshëm luajnë një rol për forcimin e ndërsjellë të këtyre pushteteve në demokraci;
- ☞ Është përgjegjësi e pronarëve të organeve të medias, duke përfshirë edhe rastet kur pronar është shteti, për të respektuar të drejtën e lirisë së shprehjes dhe, veçanërisht, pavarësinë editoriale të gazetarëve;
- ☞ Zbatimi i legjislacionit penal për shpifjen, përfshirë edhe abuzimin me të nga ana e politikanëve dhe figurave të tjera publike, përbën shkelje të standardeve ndërkombëtare. Legjislacioni penal për shpifjen duhet të shfuqizohet dhe të zëvendësohet me legjislacionin civil për shpifjen;
- ☞ Përdorimi i burimeve publike nga qeveritë dhe institucionet publike për të ndikuar në përmbajtjen e medias është i papranueshëm;
- ☞ Duhet të ketë një ndarje të qartë të veprimtarive politike nga interesat në media të atyre politikanëve që zotërojnë organe të medias. Kjo pronësi duhet t'i bëhet e ditur publikut;
- ☞ Duhet të mbrohen të drejtat investigative të gazetarëve; ata nuk duhet të mbajnë përgjegjësi penale për shkelje të sekretit kur botohen informacione të klasifikuara dhe duhet të mbrohet e drejta e tyre për mbrojtjen e anonimitetit të burimeve;
- ☞ Përqendrimi i tepruar i pronësisë së medias duhet të parandalohet përmes masave të duhura, si dispozitat për konfliktin e interesit dhe ato kundër trusteve;
- ☞ Rregullatorët e transmetimit dhe organet drejtuese duhet të mbrohen nga ndërhyrjet politike dhe me interes tregtar;
- ☞ Duhet të forcohet roli i transmetuesve publikë;
- ☞ Duhet të nxitet menaxhimi i mirë i internetit dhe duhet të parandalohet kontrolli dhe rregullimi në mënyrë të tepruar i këtij mjeti komunikimi nga qeveria;
- ☞ Duhet të bëhen përpjekje të vazhdueshme për të parandaluar shpërdorimin e ligjeve kundër gjuhës së urrejtjes dhe përpjekjet për etiketimin e fyerjes apo të pikëpamjeve kritike si ekstremizëm i dënueshëm;
- ☞ Duhet të nxitet vetërregullimi i medias si mënyra më e mirë për të shqyrtuar/korrigjuar gabimet profesionale të gazetarëve; dhe

- ✎ Nxitja e diversitetit, duke përfshirë barazinë gjinore dhe mundësitë e barabarta në mënyrë që të gjitha grupet e shoqërisë të kenë akses në valët transmetuese, duhet të jetë qëllimi kryesor i rregullimeve të transmetimeve.

# Media në Procesin Zgjedhor

Media ka një rol të rëndësishëm në çdo periudhë zgjedhore. Përveç raportimit mbi qëndrimin e zyrtarëve ekzistues, ofrimin të platformave për debat mes kandidatëve apo dhënies së mundësisë kandidatëve për t'ia komunikuar mesazhet e tyre elektoratit, si dhe raportimit mbi zhvillimet e fushatave zgjedhore, media duhet t'i informojë zgjedhësit për mënyrën se si ata mund të ushtrojnë të drejtat e tyre, të monitorojë procesin zgjedhor, duke përfshirë periudhën para ditës së zgjedhjeve dhe t'ia raportojë rezultatet publikut.

Kur vëzhgohet se si funksionon media gjatë zgjedhjeve, është e rëndësishme të shihet shkalla e autonomisë së medias, domethënë sa e lirë është nga ndërhyrjet politike apo ndërhyrje të tjera, si dhe shkalla e diversitetit të saj.<sup>1</sup> Në këtë kuadër, janë një sërë të drejtash dhe detyrash të ndërlidhura me njëra-tjetrën, që duhen marrë në konsideratë: të drejtat dhe detyrat e zgjedhësve, të partive dhe kandidatëve, si dhe të vetë medias.

## A. Të drejtat e zgjedhësve

Zgjedhësve u duhet ofruar i gjithë informacioni që u nevojitet për të ushtruar të drejtën e tyre për të votuar. E drejta e zgjedhësve për të vendosur në mënyrë të informuar nënkupton që media t'i informojë ata në mënyrë objektive dhe të saktë sa u përket platformave dhe pikëpamjeve të kandidatëve të partive të ndryshme, si dhe aktiviteteve në fushatën zgjedhore dhe në procesin zgjedhor, duke përfshirë numërimin e votave dhe shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve. Përveç kësaj, media duhet edhe t'i ndihmojë zgjedhësit duke iu shpjeguar se si ta ushtrojnë të drejtën e tyre të pjesëmarrjes politike, veçanërisht në procesin e votimit.

1 Për më shumë mbi këtë temë, shih D.C. Hallin dhe P. Mancini, "Krahasimi i sistemeve të medias: tri modelet e medias dhe politika" (Kembrixh: Shtëpia botuese "Cambridge University", 2004).

## B. Të drejtat e kandidatëve dhe partive

Kandidatët dhe partitë kanë të drejtë t'i komunikojnë lirisht platformat dhe pikëpamjet e tyre. Politikanët duhet të kenë akses në media që ta informojnë elektoratin rreth politikave dhe opinionëve të tyre për çështje me interes publik. Gjithashtu, media duhet të ofrojë një arenë ku kandidatët të mund të debatojnë. Media mund t'i mbulojë kandidatët në një sërë formatesh e t'u japë akses në një sërë mënyrash. Është vendimtare që ata të kenë mundësi të barabarta për t'i informuar zgjedhësit rreth politikave të tyre dhe të mos hasin diskriminim në mundësinë për të pasur mbulim në media. Kandidatët kanë të drejtën e përgënjeshtimit në rast deklaratash apo raportimesh të pasakta apo fyese në media, si dhe të drejtën për ta bërë këtë në kohën e duhur, gjatë të gjithë procesit zgjedhor.

Ndonëse kandidatët dhe partitë politike gëzojnë të drejtën e aksesit në media, ata nuk duhet të abuzojnë me këtë të drejtë. E drejta e politikanëve për të pasur akses në media nuk duhet të kufizojë apo të dëmtojë lirinë e shprehjes së gazetarëve. Përveç kësaj, kandidatët dhe partitë duhet, gjithashtu, të përmbushin disa detyra themelore me qëllim që të respektojnë lirinë e medias. Ata nuk duhet të ndërhyjnë në politikën editoriale të organeve të medias, përmes mënyrave të drejtpërdrejta apo të tërthorta të presionit dhe duhet të respektojnë ligjet që rregullojnë fushatën zgjedhore dhe median, duke përfshirë këtu edhe dispozitat që lidhen me periudhat e heshtjes zgjedhore.

## C. Liria e medias

Media duhet të ketë lirinë ta informojë publikun rreth fushatës zgjedhore dhe të shprehë opinionet e saj. Një nga funksionet e medias është mbulimi i çështjeve politike në mënyrë profesionale. Gjithashtu, media duhet të ketë edhe lirinë për të mbuluar të gjitha çështjet e rëndësishme lidhur me zgjedhjet, duke përfshirë punën e administratës zgjedhore, politikën dhe platformat alternative, veprimtarinë e kandidatëve dhe partive, problemet dhe incidentet që ndodhin gjatë fushatave zgjedhore, procedurat në ditën e zgjedhjeve, si dhe shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve. Përveç kësaj, media duhet gjithashtu të ketë lirinë të marrë rol aktiv në procesin e informimit të zgjedhësve, duke iu ofruar atyre një gamë të larmishme pikëpamjesh, duke përfshirë ato të gazetarëve dhe të analistëve politikë. Media duhet të ketë lirinë të ofrojë pikëpamje kritike mbi platformat e politikanëve dhe informacioneve të tyre publike. Janë një sërë faktorësh që përcaktojnë se deri në çfarë shkalle arrin media të informojë publikun, në mënyrë korrekte, të saktë, transparente dhe të balancuar. Mbi të gjitha, drejtuesit dhe pronarët e mediave duhet të pranojnë parimet e pavarësisë dhe objektivitetit gazetaresk. Ata duhet t'u kërkojnë punonjësve të tyre të veprojnë në përputhje të plotë me këto parime dhe të mos favorizojnë asnjë kandidat apo parti të caktuar.

### 2.1 Llojet e mediave dhe mbulimi i zgjedhjeve

Ndonëse media mund të klasifikohet sipas një sërë kriteresh, më i rëndësishmi për qëllimet e këtij manuali, është lloji i medias, elektronike apo e shkruar, si dhe lloji i pronësisë së saj.

## A. Media elektronike

Media elektronike është shpesh objekt i një shkalle më të madhe kontrolli dhe autoriteti publik sesa media e shkruar. Kjo justifikohet shpesh me këto dy argumente kryesore:

- Nevoja për garantimin e një shpërndarjeje të drejtë të burimeve të kufizuara publike (valëve të transmetimit dhe frekuencave); dhe
- Nevoja për të vendosur një shkallë të caktuar detyrimesh publike mbi transmetuesit. Media transmetuese (veçanërisht televizioni) konsiderohet më shumë se sa një mjet i thjeshtë komunikimi, pasi ajo është një instrument i domosdoshëm për promovimin e objektivave sociale, kulturore dhe politike. Për këtë arsye, është e rëndësishme që çdo kuadër rregullator për median – qofshin këto rregullime statutores apo vetërregullime – të garantojë përmbushjen e këtij qëllimi.

Dallimi kryesor midis organeve të medias elektronike është ai midis mediave me pronësi publike dhe atyre me pronësi private. Ky dallim ndikon tek shkalla e detyrimeve, rregullimeve dhe kontrollit që vendoset mbi to nga institucionet publike. Gjithsesi, pranohet gjerësisht që mbulimi i fushatave zgjedhore nga transmetuesit publikë dhe privatë duhet të jetë i ndershëm, i balancuar dhe i paanshëm

### *Transmetuesit shtetërorë/publikë<sup>2</sup>*

Ideja kryesore e transmetimit të shërbimit publik është se vetëm sektori privat nuk mund të garantojë pluralizëm në sferën e transmetimit. Transmetuesit e shërbimit publik ruajnë shpesh standarde më të larta përgjegjësie sa u përket parimeve të universalitetit, diversitetit, pavarësisë, llogaridhënies dhe dallimit nga transmetuesit e tjerë. Rregullimi më rigoroz që u bëhet këtyre transmetuesve justifikohet me nevojën e mbrojtjes së tyre nga ndërhyrjet apo kontrolli i papërshtatshëm nga qeveria, duke u dhënë kështu mundësinë gazetarëve që të operojnë lirshëm, në përputhje me detyrimet e tyre ndaj publikut.

Ndonëse nga të gjitha mediat elektronike pritet të ofrojnë mbulim të balancuar, të përgjegjshëm, të paanshëm dhe të ndershëm, u takon veçanërisht mediave shtetërore/publike që të ruajnë standarde rigoroz, duke qenë se ato u përkasin të gjithë qytetarëve. Përdorimi i medias shtetërore/publike për promovimin e kandidatëve apo partive të caktuara politike përbën, për këtë arsye, manipulim të paligjshëm të publikut dhe

---

<sup>2</sup> Transmetuesit e shërbimit publik financohen nga fondet publike, ofrojnë shërbim universal (për të gjithë publikun) dhe mbajnë përgjegjësi para të gjithë shtetit. Ata nuk duhet të mbështesin apo favorizojnë asnjë parti dhe asnjë qeveri. Edhe transmetuesit shtetërorë financohen nga fondet publike, por ata janë në pronësi të shtetit ose qeverisë dhe janë nën kontrollin e drejtpërdrejtë të pronarëve të tyre. Ajo çka është e rëndësishme është fakti që, cilado qoftë pronësia e tyre, këta transmetues, të financuar kryesisht me para të taksapaguesve, qoftë nga buxheti i shtetit apo nga tarifa të paguara nga qytetarët, kanë më shumë detyrime ndaj publikut sesa transmetuesit privatë sa i përket prodhimit dhe mbulimit

shpërdorim të burimeve publike. Mediat me pronësi shtetërore janë më të cenueshme ndaj presioneve të tilla nga autoritetet, sidomos në ato vende ku ato ende nuk janë transformuar në transmetues të shërbimit publik, vërtet të pavarur.

Në mbulimin prej tyre të zgjedhjeve, transmetuesit e financuar me fonde publike duhet të ofrojnë një tablo të plotë, të balancuar, të ndershme, të saktë dhe objektive të të gjithë spektrit politik, duke qenë se ata janë të mandatuar t'i shërbejnë publikut dhe të ofrojnë një gamë të larmishme, pluraliste dhe të gjerë pikëpamjesh.

### *Transmetuesit privatë*

Ndonëse transmetuesit privatë janë ndërmarrje tregtare, atyre u kërkohet shpesh të plotësojnë detyrime të caktuara (veçanërisht gjatë fushatave zgjedhore). Licenca që atyre u jepet periodikisht nga një autoritet publik, mund të përfshijë detyrime të caktuara, që lidhen me lajmet, informacionin apo programet e aktualitetit, si dhe me edukimin e zgjedhësve.

Rëndësia e transmetuesve privatë nga pikëpamja e depërtimit, mbulimit dhe audiencës, si burime informacioni në fushatat zgjedhore varet pjesërisht nga rëndësia e transmetuesve publikë. Për shembull, kur media shtetërore/publike është e vetmja që mbulon të gjithë territorin e vendit, ndërkohë që transmetuesit privatë mbulojnë vetëm zona të kufizuara gjeografike, rëndësia e këtyre të dytëve është më e kufizuar. Ndryshe nga kjo, në shtete me traditë të dobët të transmetimit publik, transmetuesit privatë kanë të ngjarë të jenë burimi i vetëm i informimit të zgjedhësve mbi zgjedhjet. Transmetuesit privatë shpesh plotësojnë organet e medias shtetërore/publike (sidomos ato që ndodhen nën një kontroll të rreptë shtetëror) duke ofruar një gamë më të larmishme apo alternative pikëpamjesh.

Transmetuesit privatë duhet të veprojnë në përputhje me standardet më të larta profesionale të gazetarisë. Pranohet gjerësisht që ata duhet, gjithashtu, të respektojnë parimin e paanshmërisë në programet e tyre informative dhe të aktualitetit.

## **B. Media e shkruar**

Kur organet e medias së shkruar janë në pronësi të autoriteteve publike, ato duhet t'i nënshtrohen të njëjtave detyrime për ndershmëri, ekuilibër dhe paanshmëri si organet publike. Ato duhet të shmangin çdo lloj diskriminimi apo anshmërie politike, pro apo kundër kandidatëve apo partive të caktuara politike.

Mediat e shkruara private kanë përgjithësisht një shkallë më të lartë anshmërie sesa media e shkruar me financime publike apo media elektronike. Prandaj, pranohet gjerësisht që shtypi i shkruar mund të shprehë qartë edhe opinionet politike. Përveç kësaj, praktika e përgjithshme e vetërregullimit miratuar nga media e shkruar (përmes kodeve të brendshme të etikës dhe këshillave të medias së shkruar) tregon se media e shkruar nuk ka nevojë të veprojë sipas rregullave të caktuara nga organe të jashtme



dhe se organet e medias mund të jenë përgjegjëse për zgjedhjet e veta editoriale. Për këtë arsye, edhe gjatë periudhave zgjedhore, mediat e shkruara private kanë më pak detyrime për të qenë të balancuara sa u përket kandidatëve dhe partive politike; ato i nënshtrohen rregulloreve më pak të rrepta sesa media elektronike, nëse ekzistojnë rregullore të tilla.

Argumenti që përdoret për justifikimin e këtij qëndrimi është që media e shkruar nuk përfiton nga ndonjë produkt, publik apo i kufizuar, siç janë valët e transmetimit. Detyrimi i tyre ndaj publikut për paanshmëri dhe balancim është, për këtë arsye, relativisht më i vogël sesa ai për mediat elektronike.

### C. Interneti dhe mediat e tjera të reja: një këndvështrim i përgjithshëm

Si rrjedhojë e daljes së mediave dhe teknologjive të reja të komunikimit, epoka e re e komunikimit politik ka ndryshuar në mënyrë rrënjësore marrëdhëniet mes garuesve dhe zgjedhësve.

Mediat e reja u ofrojnë kandidatëve dhe partive politike mundësi për t'i dhënë larmi fushatave të tyre për të arritur audiencë të ndryshme në mënyra shumë të thjeshta dhe të efektshme. Modeli "netcast", ndryshe nga modeli tradicional i transmetimit, e bën më të lehtë shpërndarjen e mesazheve specifike tek segmente të veçanta të popullsisë. Potenciali i ngjashëm shihet edhe në përdorimin e mesazheve në formë teksti në telefonat celularë, një teknikë që kandidatët kanë filluar ta përdorin në disa vende, në fushatat e tyre politike.

Padyshim që interneti e ka rritur mundësinë e ofrimit të informacionit ndaj pjesës më të madhe të popullsisë, duke u krijuar më shumë mundësi zgjedhësve të zakonshëm për të gjeneruar lajme dhe opinione politike. Nga ana teknike, edhe autoritetet zgjedhore po e përdorin tashmë internetin për të shpërndarë informacione në lidhje me procesin zgjedhor, duke përfshirë listat e zgjedhësve, ankesat e marra, hedhjen në tabelë të të dhënave dhe shpalljen e rezultateve.

Ndonëse kanë potencial të jashtëzakonshëm, ndikimi që kanë teknologjitë e reja kufizohet ende nga pabarazitë sociale. Ndarja dixhitale – aksesit i pabarabartë në teknologjitë e reja – është një pengesë e pamohueshme për përdorimin e rregullt të internetit. E njëjta gjë vlen në një shkallë më të ulët, edhe për përdorimin e telefonave celularë në komunikimet politike. Telefonat celularë përdoren më gjerësisht në vendet e varfra dhe në segmentet me të ardhura më të ulëta të popullsisë, shpesh për shkak të ekzistencës së kufizuar të linjave fikse të telefonisë (gjë që përbën nga ana tjetër një nga faktorët e kufizimit të aksesit në internet).

Roli që duhet të luajë interneti në një proces zgjedhor, çfarë rregulloresh, duhet dhe mund të vendosen për faqet e internetit dhe nëse duhen vendosur rregullore të tilla, janë që të gjitha çështje të diskutueshme, sidomos sa u përket periudhave të heshtjes zgjedhore dhe sondazheve. Kjo është pjesë e një debati më të madh rreth shkallës së

lirisë që duhet të gëzojë interneti dhe shkallës në të cilën mund të vendosen në mënyrë realiste rregullore për këtë lloj mjeti komunikimi. Në përgjithësi, çdo kufizim i lirisë së përdoruesve dhe publikuesve të internetit nuk është pritur edhe aq mirë. *World Wide Web* është një treg pluralist dhe i pakufizuar idesh, i aksesueshëm parimisht për të gjithë. Ai mbetet gjerësisht i parregulluar ligjërisht, ndonëse shumë mund të mendojnë se ky treg as nuk mund të rregullohet dhe as nuk duhet të rregullohet.

Prova të ndikimit që mund të ketë interneti mund të shihen në përpjekjet e shpeshta nga shtete apo qeveri të caktuara për të kontrolluar aksesin në *World Wide Web*, përmes një sërë mekanizmash, duke përfshirë zotërimin e drejtpërdrejtë nga shteti të ofruesve të internetit, kontrollin mbi arkivat e ofruesve të shërbimit apo përpjekjet për të penguar hyrjen në faqe interneti “politikisht të diskutueshme”. Edhe ofruesit e përmbajtjes mund t’i nënshtrohen të njëjtit presion si gazetarët e medias tradicionale.

# Monitorimi i Medias në Misionet e Vëzhgimit të Zgjedhjeve: Vështrim i Përgjithshëm


## 3.1 Detyrat e analistit të medias

Në thelb, detyra e analistit të medias është të mbledhë informacione të mjaftueshme dhe të besueshme për të analizuar dhe për të nxjerrë përfundime në lidhje me performancën e medias gjatë një periudhe zgjedhore (qoftë kjo periudha parazgjedhore – e përkufizuar si periudha nga shpallja e zgjedhjeve e deri në fillimin e fushatës zgjedhore – periudha e fushatës, apo periudha pas fushatës zgjedhore deri në shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve apo largimit të MVZ-së nga vendi) me qëllim ofrimin e rekomandimeve për përmirësimin e kësaj pjese të procesit zgjedhor. Analisti i medias mund të përdorë një sërë metodash për mbledhjen e informacioneve të nevojshme. Ai/ajo e bën këtë si pjesë e një ekipi që përfshin një njësi të dedikuar për monitorimin e medias dhe disa analistë të ekipit kryesor të MVZ-së, që analizojnë pjesë të tjera të procesit zgjedhor për qëllime të misionit.

Në pjesën tjetër të këtij kapitulli trajtohen disa çështje dhe pyetje specifike, që lidhen me rolin e analistit të medias, duke filluar me një përshkrim të përgjithshëm të pozicionit të analistit të medias në ekipin kryesor dhe me funksionet e njësisë së monitorimit të medias.

## 3.2 Roli i analistit të medias në një mision të vëzhgimit të zgjedhjeve (MVZ)

Puna e analistit të medias përfshin një ndërveprim të veçantë me anëtarë të ndryshëm të MVZ-së:

-  **Kreun e misionit:** analisti i medias e këshillon kreun e misionit për çështje që lidhen me median, duke përfshirë edhe mbulimin nga media të MVZ-së. Analisti i medias e përditëson gjithashtu, rregullisht, kreun e misionit mbi gjetjet nga

monitorimi i medias. Përveç kësaj, analisti i medias mund të bëhet pika fokale për median në lidhje me MVZ-në.

- 📌 **Analistin ligjor:** analistit të medias i duhet të punojë ngushtë me analistin ligjor për studimin e kuadrit ligjor, që rregullon median. Ky bashkëpunim është gjithashtu shumë i rëndësishëm në rastet e paraqitjes së ankesave që lidhen me median para komisioneve zgjedhore, organeve rregullatore apo gjykatave. Çdo ndjekje e këtyre ankesave duhet të monitorohet në bashkëpunim me analistin ligjor;
- 📌 **Analistin e zgjedhjeve:** analisti i zgjedhjeve i ofron analistit të medias një listë të kandidatëve dhe udhëzimeve apo vendimeve të komisioneve zgjedhore në lidhje me mediat. Analisti i medias i ofron analistit të zgjedhjeve informacione në lidhje me fushatat në media për **edukimin** e zgjedhësve dhe lajmet që kanë të bëjnë me administrimin e zgjedhjeve;
- 📌 **Analistin politik:** analisti politik i ofron analistit të medias informacione në lidhje me peizazhin politik dhe me ankesat që lidhen me median, të paraqitura nga kandidatët dhe partitë politike. Edhe informacionet në lidhje me financimin apo kufizimet e financimeve të shpenzimeve për fushatat zgjedhore të kandidatëve të caktuar apo partive të caktuara politike, mund të jenë të rëndësishme në rast se legjislacioni vendas lejon reklama politike me pagesë. Analisti i medias i ofron analistit politik informacione në lidhje me mbulimin dhe analizimin nga media të programeve dhe platformave zgjedhore të partive politike dhe kandidatëve;
- 📌 **Koordinatorin e vëzhguesve afatgjatë dhe vëzhguesit afatgjatë:** koordinatori i vëzhguesve afatgjatë mund t'u kërkojë vëzhguesve afatgjatë që të mbledhin informacione rreth mediave lokale dhe kufizimeve të mundshme të lirisë së medias, me të cilat përballen gazetarët. Në disa raste, vëzhguesve afatgjatë mund t'u kërkohet të mbledhin materiale të regjistruara apo të botuara për llogari të njësisë së monitorimit të medias;
- 📌 **Analistin e përkatësisë gjinore:** analisti i përkatësisë gjinore duhet t'i kërkojë analistit të medias informacione për mënyrën e mbulimit të të dyja gjinive nga media, për shembull mbi përqindjen e mbulimit nga media, krahasuar me paraqitjet e kandidatëve; dhe
- 📌 **Analistin e pakicave kombëtare:** analisti i pakicave kombëtare duhet t'i kërkojë analistit të medias informacione për mënyrën e mbulimit të çdo pakice kombëtare nga media, sidomos të kandidatëve apo partive nga këto grupe.

### 3.2.1 Njësia e medias

Njësia e monitorimit të medias të një MVZ-je përbëhet zakonisht, nga disa monitorues vendas të medias. Stafi mbështetës vendas i ofron asistencë thelbësore analistit të medias, në përbushjen e detyrave të tij/saj duke përfshirë përkthimin me shkrim, përkthimin me gojë dhe monitorimin e përmbajtjes së medias.

Kur përzgjedh për punësim stafin mbështetës vendas, analisti i medias kërkon monitorues të familjarizuar me kontekstin politik dhe me situatën e medias në vend. Zakonisht, preferohen monitorues lokalë, që kanë një formim në fushën e studimeve të medias dhe/ose përvojë në studimet sociologjike. Monitoruesit nuk duhet të punojnë si gazetarë, pasi përfshirja e tyre në sektorin e medias do të krijonte konflikt interesi. Përveç kësaj, monitoruesit e medias nuk duhet të jenë anëtarë të partive apo lëvizjeve politike, për të shmangur spekulimet apo akuzat sa i përket paanshmërisë së tyre.

Me krijimin e ekipit, analisti i medias duhet t'u ofrojë atyre trajnimin e nevojshëm për kryerjen si duhet të detyrave. Ky trajnim mund të ndahet në dy faza:

1. Në fazën e parë, analisti shpjegon qëllimin e analizimit të medias, metodologjinë që do të zbatohet, si dhe llojin e produktit që pritet. Metodologjia u ofrohet anëtarëve të ekipit me shkrim, së bashku me shembuj dhe raste konkrete për diskutim. Kjo fazë duhet të zgjasë rreth tre ditë.
2. Në fazën e dytë, e cila zgjat rreth katër ditë, analisti i medias punon ngushtësisht me çdo anëtar të ekipit për të vlerësuar se çfarë ka mësuar anëtarët dhe nëse ai/ajo është gati për të përmbushur detyrat e kërkuara.

Monitoruesve të medias u vihen gjithashtu në dispozicion legjislacioni dhe rregulloret, që rregullojnë mbulimin mediatik gjatë një fushate zgjedhore, "Manuali për vëzhgimin e zgjedhjeve" i ODIHR-it, *kodi i sjelljes i ODIHR-it për vëzhguesit e zgjedhjeve*, si dhe çdo dokument tjetër, që u nevojitet për të kuptuar mirë qëllimet e aktiviteteve të tyre dhe qëllimin e përgjithshëm të MVZ-së.

Për të eliminuar çdo element subjektivizmi apo devijimi nga kjo metodologji, analisti i medias përdor mekanizma kontrolli, të cilat përfshijnë teste besueshmërie, që kryhen mes monitoruesve të medias, kontrole të vazhdueshme të të dhënave të mbledhura, si dhe mbikëqyrjen e raporteve të përditshme të monitoruesve.

### *Kodi i sjelljes*

Është e domosdoshme që të gjithë anëtarët e MVZ-së, duke përfshirë edhe stafin mbështetës vendas, t'i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të tillë, që të jenë në përputhje me kodin e sjelljes të ODIHR-it për vëzhguesit e zgjedhjeve. Anëtarët e MVZ-së mund të kenë edhe opinionet e tyre politike, por ata nuk duhet të lejojnë që ato t'u ndërhyjnë në punën e tyre.

### **3.3 Analizimi i medias: Çfarë përpiqemi të vlerësojmë?**

Ndonëse analisti i medias trajton edhe mënyrën se si veprojnë gazetarë apo organizata të ndryshme mediatike, ky interes është pjesë e kontekstit të sistemit të medias si një i tërë. Në analizimin e medias gjatë një fushate zgjedhore, analisti i medias vlerëson se

sa autonom është sistemi i medias nga sistemi politik, si dhe sa i larmishëm është vetë sistemi brenda për brenda.

Në përmbushjen e kësaj detyre, analisti i medias merr parasysh të drejtat bazë të secilit prej aktorëve që përmenden në Kapitullin 2:

- 📌 Të drejtat e zgjedhësve për t'u informuar;
- 📌 Të drejtat e kandidatëve për të përçuar informacione; dhe
- 📌 E drejta e medias për lirinë e shprehjes.

### **Të drejtat e zgjedhësve për t'u informuar**

Për të përcaktuar nëse zgjedhësve iu është dhënë akses i duhur në informacion, në periudhën e fushatës zgjedhore, analisti i medias duhet të shqyrtojë çështjet e mëposhtme:

- 📌 A morën zgjedhësit mjaftueshëm informacion të larmishëm dhe të balancuar, që të ishin të aftë të bënin një zgjedhje të mirinformuar?
- 📌 A u ofroi media zgjedhësve informacion të mjaftueshëm në lidhje me administrimin e zgjedhjeve dhe me procedurat e votimit? A kishte programe të mjaftueshme për edukimin e zgjedhësve për ta informuar elektoratin në mënyrë të efektshme dhe të saktë në lidhje me procesin e votimit?
- 📌 A e përmbushi media shtetërore/publike detyrimin e saj për ta informuar publikun në lidhje me çështje që i përkasin procesit zgjedhor?
- 📌 A ishte media shtetërore/publike e lirë të luante një rol të paanshëm, të ndershëm dhe objektiv në mbulimin e të gjithë kandidatëve dhe partive politike apo pati një qasje selektive në ofrimin e informacioneve për ngjarje të ndryshme? A u zgjodhën temat për nga vlera e tyre informuese apo kishin si qëllim përshkrimin e një partie të caktuar politike në mënyrë pozitive apo negative?
- 📌 A iu ofrua ndonjë trajtim i posaçëm - pozitiv apo negativ - ndonjë kandidati apo partie të caktuar politike?
- 📌 A u respektuan nga media dhe nga partitë politike dispozitat e parashikuara në kuadrin ligjor vendas, përfshirë ato që lidhen me sondazhet dhe me periudhat zgjedhore?
- 📌 A pati ndonjë paragjykim në raportim me bazë etninë, besimin fetar, përkatësinë gjinore apo statusin social?

### ***Të drejtat e kandidatëve për të dhënë informacion***

Analisti i medias duhet të fokusohet në një sërë çështjesh për të vlerësuar nëse kandidatët e patën mundësinë e nevojshme për t'u komunikuar informacione, zgjedhësve:

- ✎ A iu dhanë kandidatëve dhe partive politike në zgjedhje mundësi të barabarta për t'ia prezantuar fushatat dhe platformat e tyre, elektoratit, përmes medias?
- ✎ A patën kandidatët apo partitë politike në zgjedhje, akses të barabartë<sup>3</sup> ose proporcional dhe pa diskriminim, në median publike/shtetërore?
- ✎ A patën kandidatët në zgjedhje akses të lirë, pa pengesa, në media? A pati pengesa ligjore apo administrative?
- ✎ A u trajtuan ndershmërisht kandidatët apo partitë politike në zgjedhje, nga organet shtetërore apo publike të medias?
- ✎ A iu nënshtruan kandidatët dhe partitë politike në zgjedhje, të njëjtave kushte (tarifa, minutazh etj.) për reklamat e paguara?
- ✎ A ishin të paanshme llojet e ndryshme të programeve televizive, që kanë lidhje me procesin, si për shembull, edicionet informative apo debatet e ndryshme?

### *Liria e shprehjes së medias*

Për të përcaktuar nëse u respektua liria e shprehjes së medias, analisti i medias duhet t'i përgjigjet një sërë pyetjesh:

- ✎ A hasi media ndonjë lloj censure apo pengese nga autoritetet?
- ✎ A u detyruan gazetarët të modifikonin komentet apo kritikët e tyre për t'i bërë ato të pranueshme nga autoritetet? A u përfshinë gazetarët në autocensurë?
- ✎ A u dënua penalisht apo u ngacmua ndonjë organ mediash apo gazetarët si individë, në ndonjë lloj mënyre, vetëm për shkak të programit të transmetimit apo artikujve të publikuar, që ishin kritikë ndaj qeverisë apo ndaj autoriteteve të tjera dhe/ose politikave të tyre?
- ✎ A u ndeshën organet e medias me ndonjë lloj ndërhyrjeje në politikën e tyre editoriale nga autoritetet, partitë politike apo pronarët e mediave?
- ✎ A përqaftuan gazetarët ndonjë pikëpamje të caktuar, në këmbim të përfitimeve financiare apo përfitimeve të tjera?

---

<sup>3</sup> Barazi do të thotë që çdo parti apo kandidat të marrë të njëjtën sasi kohe apo hapësire në media. Paanësia nënkupton që kandidatët në zgjedhje të marrin akses në media, në një raport të drejtë, në bazë të kritereve të qarta dhe të njëjta (për shembull: numri i vendeve në parlament apo numri i kandidatëve)





# Udhëzime për Monitorimin e Medias: Çështjet e Ndjeshme, Standardet Bazë dhe Praktikrat e Mira

Për të vlerësuar rolin dhe performancën e medias në një proces zgjedhor, analisti i medias duhet të marrë parasysh një sërë elementesh. Analizimi i medias është shumë më shumë sesa thjesht monitorim i përmbajtjes së mbulimit të një fushate zgjedhore nga ana e medias. Ky mbulim varet nga kuadri ligjor për zgjedhjet dhe nga konteksti, në të cilin zhvillohen zgjedhjet. Për të bërë një vlerësim të përshtatshëm të rolit të medias gjatë një fushate zgjedhore, analisti i medias duhet të fokusohet në këto tre fusha kryesore:

- 👉 Kuadri ligjor për median;
- 👉 Peizazhi mediatic dhe marrëdhëniet midis medias dhe aktorëve përkatës, duke përfshirë autoritetet shtetërore, partitë politike dhe pronarët e mediave; dhe
- 👉 Monitorimi i mbulimit të fushatës zgjedhore nga ana e medias.

Vlerësimi i përgjithshëm duhet të bëhet duke u bazuar pikësisht në respektimin e angazhimeve të OSBE-së, standardet e tjera ndërkombëtare të zbatueshme, si dhe në legjisllacionin vendas. Këtu, lind pyetja themelore: A u respektuan të drejtat dhe liritë e zgjedhësve, kandidatëve, partive dhe medias gjatë procesit zgjedhor? Përveç kësaj, duhet vlerësuar edhe respektimi i legjisllacionit vendas, i cili duhet të jetë gjithashtu në përputhje me standardet ndërkombëtare. Vlerësimi kryesor që duhet bërë është nëse kuadri ligjor ishte apo jo, në përputhje me angazhimet politike dhe ligjore, të ndërmarra nga vendi përkatës dhe nëse ishte kështu, a u respektuan apo jo, dispozitat ligjore vendase.

#### 4.1 Kuadri ligjor, rregulloret për zgjedhjet, administrimi i zgjedhjeve dhe organet rregullatore të medias

Aspekti më i rëndësishëm i rregullimit të medias gjatë zgjedhjeve është gjetja e ekuilibrit të duhur midis respektimit të pavarësisë editoriale dhe nevojës për balancimin e rregullave që garantojnë mbulimin mediatik. Masat vullnetare, të marra nga vetë profesionistët e medias, veçanërisht në formën e kodeve të etikës apo udhëzimeve të brendshme për mbulim të përgjegjshëm dhe të ndershëm të fushatave zgjedhore, janë plotësime të dobishme ose alternativa ndaj legjislationit apo rregullores vendase.

Kuadri ligjor dhe zgjedhor është rezultat i një sërë traditash dhe praktikash specifike vendase dhe nuk ekziston asnjë lloj modeli universal, që do të prodhonte të njëjtat rezultate në kontekste të ndryshme. Megjithatë, në thelb të këtyre rregullave, praktikave dhe sjelljeve qëndrojnë disa parime bazë, që parashikohen në kuadrot ligjore dhe rregulloret për zgjedhjet.

##### Udhëzime

Konsistenca e kuadrit ligjor	Kuadri ligjor që rregullon median dhe fushatat gjatë një procesi zgjedhor duhet të jetë në pajtim me parimet e parashikuara në të drejtën ndërkombëtare, në fushën e lirisë së shprehjes. Nëse nuk ka konsistencë, kuadri ligjor duhet rishikuar dhe duhet të harmonizohet me angazhimet e OSBE-së dhe me standarde të tjera ndërkombëtare në këtë fushë.
------------------------------	---

Rregullimi i medias	Normat që rregullojnë median gjatë një fushate zgjedhore duhet të përkufizohen qartë dhe të mos lënë hapësirë për manipulim apo keqinterpretim. Rregullimi duhet të ketë kryesisht si qëllim mbrojtjen e të drejtave të zgjedhësve dhe të kandidatëve për lirinë e shprehjes. Çdo kufizim i mbulimit mediatik duhet të vendoset vetëm për këtë qëllim dhe duhet të jetë proporcional me objektivin që kufizimi kërkon të arrijë ai.
---------------------	---

Fushat e ndryshme të rregullimit mund të përfshijnë elemente që mund të ndikojnë padrejtësisht tek zgjedhësit, si për shembull shpërndarja e sondazheve, periudhat e heshtjes, gjuha e urrejtjes, aksesit i pabarabartë dhe trajtimi i pandershëm.

Rregulloret nuk duhet të jenë më kufizuese sesa duhet dhe nuk duhet të pengojnë në mënyrë të panevojshme, pavarësinë editoriale të organeve të medias. Gjatë procesit të hartimit të tyre rekomandohet që përfaqësuesit e partive politike dhe të medias të konsultohen me qëllim nxjerrjen e një sërë rregullash që bazohen në konsensusin e të gjithë aktorëve të përfshirë.

Gjithashtu, sistemi i vetërregullimit mund të jetë një mundësi e efektshme zgjedhjeje, nëse ekzistojnë kushtet që lehtësojnë mbulimin gazetaresk, të përgjegjshëm dhe të pavarur.

---

**Organi mbikëqyrës** Organi që rregullon mbulimin mediatic gjatë zgjedhjeve duhet të jetë i pavarur dhe i besueshëm dhe duhet të konsiderohet i ligjshëm nga të gjitha forcat politike, që marrin pjesë në zgjedhje. Në përgjithësi, organet rregullatore nuk duhet t'i interpretojnë dispozitat për fushatat në mënyrë kufizuese. Emërimi i anëtarëve të këtyre organeve nuk duhet të jetë objekt i asnjë kontrolli ekskluziv të qeverisë dhe duhet të respektojë parimet që rregullojnë emërimet apo aktivitetet e të gjithë administratës zgjedhore. Këto parime janë:

- Anëtarët duhet të jenë të kualifikuar si duhet dhe të paanshëm;
- Procedurat e emërimit duhet të jenë transparente;
- Anëtarët duhet të sillen në mënyrë të pavarur dhe objektive;
- Publiku (përfshirë dhe vëzhguesit vendas dhe ata ndërkombëtarë) duhet të ketë akses në dokumentacionin përkatës;
- Anëtarët duhet të mbrohen nga heqja arbitrare nga ky pozicion.

Organi përgjegjës për mbikëqyrjen e mbulimit mediatic mund të jetë:

- Një organ i përhershëm rregullator i medias. Ky organ mund të punojë në mënyrë autonome ose bashkërisht me administratën zgjedhore;
- Organi kryesor i administratës zgjedhore (p.sh.: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve)
- Një organ vetërregullues, si p.sh.: këshillat vullnetare të medias që ekzistojnë në shumë shtete; ose
- Një organ i krijuar posaçërisht për periudhën zgjedhore, i ngarkuar me rregullimin dhe mbikëqyrjen e mbulimit mediatic vetëm gjatë fushatës zgjedhore;
- Organi zbatues duhet të ketë përvojën, burimet, njohuritë dhe mandatin për të monitoruar respektimin e rregullave, për të hetuar shkeljet e pretenduara, si dhe për të marrë masa të efektshme dhe në kohën e duhur, në rast shkeljeje. Monitorimi sistematik i medias gjatë një fushate zgjedhore do ta ndihmonte këtë organ, në përmbushjen e këtyre detyrave.

---

**Ankesat** Organi zbatues duhet të veprojë në përgjigje të ankesave të kandidatëve dhe partive politike ose sa herë që identifikon një shkelje të rregulloreve, pavarësisht nëse është paraqitur apo jo ndonjë ankesë.

Duhet të përcaktohen procedura për marrjen, investigimin, dëgjimin dhe zgjidhjen e ankesave të kandidatëve, partive politike apo të tjerëve, në lidhje me mbulimin e pandershëm apo të paligjshëm mediatic. Këto procedura duhet të zbatohen në kohën e duhur dhe duhet të jenë të qarta dhe të aksesueshme, në mënyrë që ankuesve t'u jepet një zgjidhje sa më e shpejtë.

Sanksionet e vendosura nga organi mbikëqyrës, duhet të jenë në raport të drejtë me shkallën e shkeljes së kryer. Këto nuk duhet të përfshijnë dënimin me burg apo çfarëdolloj mase tjetër, që do ta pengonte median të kryente aktivitetet e saj apo që do të inkurajonte autocensurën mes gazetarëve.

Sanksione ekstreme - si pezullimi i përkohshëm i transmetimeve apo i licencës - duhen vendosur vetëm në rast shkeljesh shumë të rënda apo të përsëritura dhe duhet të jenë objekt i së drejtës për apelim gjyqësor.

---

**Apelimi** Organet e medias dhe ankuesit duhet të kenë të drejtën të ankohen ndaj vendimeve të marra nga organi zbatues, përmes një mekanizmi apelimi që zbatohet në kohën e duhur dhe është i aksesueshëm dhe i menjëhershëm.

---

## 4.2 Peizazhi mediatik dhe roli i autoriteteve

Shteti dhe veçanërisht qeveria kanë përgjegjësi të dyfishtë në procesin zgjedhor:

- Të mos ndërhyjnë padrejtësisht në aktivitetet e medias dhe të mos i pengojnë gazetarët në funksionet e tyre; dhe
- Të garantojnë pluralizëm dhe të mbështesin të drejtën e lirisë së medias.

## 4.3 Mbulimi nga media

### A. Pluralizmi dhe rregullimi ligjor

Një dilemë e vazhdueshme është se deri në çfarë shkalle duhet të rregullohet media sa i përket mbulimit të kandidatëve apo partive politike gjatë një fushate zgjedhore. Mbulimi nga media i zgjedhjeve përfshin çështje të ndërlikuara dhe të larmishme, që mund të trajtohen përmes rregullimit apo vetërregullimit, ose që mund të lihen edhe të parregulluara.

Një nga çështjet që duhet të trajtohet është nëse nevojitet rregullim i jashtëm apo vetërregullim. Zakonisht, gazetarët nuk janë pro asnjë lloj rregullimi të jashtëm sa i përket lirisë së tyre editoriale. Megjithatë, sektori i medias mund të mos jetë aq autonom sa të mund t'i mbrojë gazetarët dhe kryeredaktorët nga presioni, ndikimi i autoriteteve apo aktorëve të tjerë politikë. Në këto raste, rregullimi i jashtëm mund të garantojë të drejtat e zgjedhësve dhe kandidatëve për të marrë dhe për të dhënë informacion, sipas rastit.

### B. Avantazhi i kandidatëve dhe partive në pushtet

Të qenit pjesë e qeverisë do të thotë që të mund të marrësh më shumë vëmendje nga mediat, për shkak të nevojës së mbulimit të aktiviteteve të ekzekutivit, përfshirë edhe eventet zyrtare, takimet dhe zbatimet e politikave të ndryshme. Këto evente mund të jenë të vërteta dhe të rëndësishme (si p.sh.: festime kombëtare, përvjetorë, nënshkrime të traktateve ndërkombëtare etj.); të vërteta, por jo aq të rëndësishme (si p.sh.: hapja e godinave publike), por edhe pseudoevente (raste të sajua apo të menaxhuara nga qeveria, me qëllim përfitim të një mbulimi më të gjerë e pozitiv mediatik). Gjithashtu, qeveria është edhe politikëbërësja kryesore dhe mbulimi nga media nevojitet për ta mbajtur publikun të informuar. Ndonëse kandidatët dhe partitë në pushtet janë zakonisht më të ekspozuar ndaj medias sesa konkurrentët e tyre në zgjedhje, media duhet t'i mbulojë aktivitetet e autoriteteve në mënyrë të balancuar dhe kritike, duke u fokusuar tek rezultatet, sukseset dhe dështimet. Media duhet të ofrojë një platformë për mendime të pavarura dhe kritike, duke i ofruar publikut pikëpamje të mirinformuara reth performancës së autoriteteve në detyrë.

Anëtarët e ekzekutivit të një vendi duhet të veprojnë në të mirë të të gjithë vendit, por ata shpesh përfaqësojnë edhe një parti politike. Konflikti që mund të lindë midis këtyre dy aktiviteteve, bëhet veçanërisht problematik gjatë fushatave zgjedhore sa iu përket këtyre dy të drejtave:

- ✎ Të drejtës për mundësi të barabarta aksesi në media për kandidatët, e cila duhet të balancohet me lirinë dhe detyrimin e medias për të mbuluar aktivitetet qeveritare; dhe
- ✎ Të drejtës për trajtim të barabartë të kandidatëve.

#### 4.4 Rregullimi i mbulimit nga media gjatë zgjedhjeve

Një tjetër problem lidhet me objektivat e rregullimit të mbulimit nga media. Cilat programe duhen rregulluar? Sipas cilave kriteresh? Fushat kryesore me interes janë lajmet dhe programet për aktualitetin, debatet mes kandidatëve, minutazhi falas, reklamat e paguara politike dhe edukimi i zgjedhësve.

Më poshtë janë disa udhëzime bazë, që duhen pasur parasysh në vëzhgimin e mbulimit të fushatave zgjedhore në media.

##### Detyrimet kryesore

Media shtetërore / publike (elektronike dhe e shkruar) duhet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• t'u ofrojë kandidatëve dhe partive në zgjedhje, mundësi të barabarta ose proporcionale për akses dhe trajtim të ndershëm;</li> <li>• të ofrojë mbulim që plotëson kriteret për një raportim të ekuilibruar, pluralist dhe të paanshëm;</li> <li>• të jetë në përputhje me dispozitat për mbulimin e zgjedhjeve, siç parashikohet në legjislacionin vendas;</li> <li>• të garantojë raportim pluralist, pasi ato janë "pronë publike";</li> <li>• t'u përmbahet standardeve profesionale dhe të etikës gazetareske</li> </ul>
Media elektronike private duhet:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të veprojnë në përputhje me dispozitat për mbulimin e zgjedhjeve, siç parashikohet në legjislacionin vendas; dhe</li> <li>• t'u përmbahet standardeve profesionale dhe të etikës gazetareske</li> </ul>
Media e shkruar private duhet:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të veprojnë në përputhje me dispozitat për mbulimin e zgjedhjeve, siç parashikohet në legjislacionin vendas, si dhe me standardet profesionale dhe etike gazetareske; dhe</li> <li>• të jetë e çliruar nga ndërhyrjet rregullatorë, që mund të ndikojnë në pavarësinë editoriale apo në të drejtën për të shprehur preferenca politike</li> </ul>

##### *Mbulimi i lajmeve*

Paragrafi 7.8 i Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së, të vitit 1990, parashikon që të mos ketë asnjë pengesë ligjore apo administrative në aksesin në media, për të gjitha grupimet politike apo individët që dëshirojnë të marrin pjesë në procesin zgjedhor pa diskriminim. Për këtë arsye, shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së duhet t'u ofrojnë

konkurrentëve mundësi të mjaftueshme për informimin e publikut rreth kandidaturave dhe platformave të tyre, në mënyrë jodiskriminuese dhe të paanshme.

Duke qenë se shumë njerëz informohen rreth politikës përmes lajmeve, është veçanërisht e rëndësishme që media të ketë një qasje të balancuar dhe të paanshme në raportimin e lajmeve të tyre mbi fushatën zgjedhore, pa asnjë lloj diskriminimi ndaj kandidatëve apo partive të caktuara politike.

### Mbulimi i lajmeve Niveli i lartë i kontrollit editorial të medias

Media shtetërore/ publike (media elektronike dhe e shkruar)	<ul style="list-style-type: none"><li>Media shtetërore/publike ka detyrimin të prodhojë një mbulim të ndershëm, objektiv dhe të balancuar të ngjarjeve aktuale dhe lajmeve që lidhen me zgjedhjet. Ky detyrim mund të përmbushet me vetërregullim ose me ligj;</li><li>E drejta e raportimit përbën një aspekt themelor të gazetarisë. Sa u përket lajmeve, çështja kryesore është nëse mbulimi nga media publike duhet të rregullohet në mënyrë rigorozë, të rregullohet vetëm sa i përket mbulimit të zgjedhjeve, apo të mos rregullohet fare. Në vendet që kanë një traditë të lirisë së shprehjes, aktorët politikë i besojnë zakonisht sistemit dhe aty ku ka një praktikë të mirëkonsoliduar të vetërregullimit, mund të mos ketë nevojë për dispozita të tjera të jashtme. Në vendet ku mungon besimi mes partive politike, gazetarëve dhe institucioneve, mund të nevojitet një rregullim më rigoroz me qëllim mbrojtjen e medias publike nga ndërhyrjet e panevojshme;</li><li>Për të siguruar një larmi zërash mund të përdoren shumë qasje. Opinionet e qeverisë apo të partisë së shumicës duhet të ekuilibrohen me pikëpamjet e kundërta, të pavarura ose alternative; mbulimi i ngjarjeve apo deklaratave publike të bëra nga partitë në qeverisje mbi çështje me interes publik duhet të balancohen me mbulimin e pikëpamjeve të opozitës, të ekspertëve të pavarur dhe të tjerëve. Komentet - qofshin ato të raportuara nga prezantuesi i një programi apo të bëra nga ekspertë të jashtëm - duhet të dallohen qartësisht nga faktet dhe duhet të reflektojnë një larmi pikëpamjesh.</li></ul>
Media elektronike private	<ul style="list-style-type: none"><li>Çështja kryesore sa u përket transmetuesve privatë lidhet me ekuilibrin mes natyrës së tyre si ndërmarrje tregtare dhe përdorimit prej tyre të valëve publike, gjë që krijon disa detyrime sa i përket ofrimit të një shërbimi publik. Në disa vende, dhënia e licencës shoqërohet me një nivel të caktuar detyrimesh publike;</li><li>Nga pikëpamja teorike, media private, në tërësi, duhet të garantojë pluralizmin e informacioneve, pikëpamjeve, ideve dhe opinionëve. Për këtë arsye, disa media të pavarura me linja të larmishme editoriale, mund t'i shërbejnë qëllimit të prodhimit të një sistemi pluralist informacioni dhe aksesit (pluralizmi i jashtëm);</li><li>Pavarësisht lirisë editoriale që gëzojnë transmetuesit privatë, gazetarët duhet t'u përmbahen standardeve profesionale të mbulimit dhe të etikës profesionale.</li></ul>

Media e shkruar private	<ul style="list-style-type: none"> <li>Media e shkruar private nuk është e detyruar të respektojë ndonjë rregullore të caktuar në lidhje me zgjedhjet sa i përket shpërndarjes së hapësirës mes forcave politike. Megjithatë, gazetarët duhet t'u përmbahen standardeve profesionale të mbulimit dhe të etikës profesionale.</li> </ul>
-------------------------	---

### *Programet e aktualitetit dhe programet politiko-informative*

Emisionet, diskutimet dhe debatet politike mes kandidatëve dhe përfaqësuesve të tyre, plotësojnë mbulimin e zgjedhjeve me lajme dhe janë të rëndësishme duke qenë se i japin mundësi publikut të bëjë krahasime të drejtpërdrejta midis kandidatëve në një format ndërveprues. Gjatë këtyre programeve mund të ngrihen çështje të ndryshme politike, ekonomike dhe sociale, dhe kandidatëve iu duhet të shpjegojnë se si do t'i trajtonin ata këto probleme nëse do të zgjidheshin.

Këto lloj programesh duhet të organizohen në mënyrë të tillë që të prezantojnë pikëpamje të ndryshme. Pjesëmarrësit që përfaqësojnë alternativa të ndryshme politike, duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të jenë në gjendje të paraqesin lirisht pikëpamjet dhe platformat e tyre. Megjithatë, vendimi se si mund të arrihet sa më mirë kjo lloj barazie (p.sh.: duke përcaktuar formatin, numrin e pjesëmarrësve, kohëzgjatjen e diskutimit etj.) mund të rregullohet me ligj ose t'i lihet në dorë vetë organit transmetues. E rëndësishme është që rregullat të mos ndryshojnë në mes të lojës. Media nuk duhet të mbajë përgjegjësi për deklaratat e paligjshme, që mund të bëjnë kandidatët apo përfaqësuesit e partive politike dhe që transmetohen gjatë fushatës zgjedhore. Të vetmit që duhet të mbajnë përgjegjësi për to, janë individët që i bëjnë këto deklaratat.<sup>4</sup>

### *Minutazhi/hapësira falas*

Në disa vende është praktikë e zakonshme që transmetuesit e shërbimit publik t'u ofrojnë minutazh falas kandidatëve apo partive politike, që ato t'ia komunikojnë mesazhet e tyre elektoratit. Kjo konsiderohet një lloj forme e drejtpërdrejtë komunikimi mes politikanëve dhe zgjedhësve, pa asnjë lloj roli ndërmjetësues nga media. Një nga avantazhet kryesore të ofrimit të minutazhit falas është që partive të vogla apo kandidatëve jo shumë të njohur, t'u jepet mundësia të përçojnë mesazhet e tyre zgjedhore, pasi, në kushte të tjera, ata nuk do të kishin mundësi të merrnin mbulim të konsiderueshëm mediatik. Zakonisht, minutazhi falas rregullohet me ligj ose me rregullore të nxjerra nga komisioni qendror i zgjedhjeve apo nga organe të tjera përkatëse.

Ndonëse minutazhi falas mund të marrë forma të ndryshme, transmetime të tilla kanë tri veçori të përbashkëta:

- 👉 Në mesazhin e paraqitur nga kandidatët apo partitë politike nuk ka asnjë lloj ndërmjetësimi gazetaresk apo kontrolli editorial;

<sup>4</sup> Që organet mediatike të mbajnë përgjegjësi për fjalimet e kandidatëve, duhet që kryeredaktorët të filtrojnë të gjitha transmetimet dhe të veprojnë si censurues.

- Objektivi kryesor është përcimi i mesazheve të kandidatëve zgjedhësve, informimi rreth alternativave politike, që u ofrohen qytetarëve, si dhe diskutimi i çështjeve që lidhen me procesin zgjedhor; dhe
- Ofrimi i minutazhit falas partive dhe kandidatëve dhe mbulimi i kostove bëhet përgjithësisht nga shteti.

Në këtë aspekt, natyra e këtyre transmetimeve ndryshon nga ajo e programeve të tjera që mbulojnë zgjedhjet, siç janë debatet apo tryezat e rumbullakëta, ku nevojitet ndërmjetësimi i gazetarëve dhe ku ka një kontroll editorial të organit të medias.

### Minutazhi/hapësira falas

Media  
shtetërore /  
publike

- Partive politike dhe kandidatëve mund t'u ofrohet akses i drejtpërdrejtë falas në mediane publike. Nëse është kështu, nuk duhet të përjashtohet asnjë parti politike apo kandidat që merr pjesë në zgjedhje nga përfitimi i këtij minutazhi falas. Sasia e kohës së dhënë duhet të jetë e mjaftueshme që t'u japë mundësi kandidatëve t'ia komunikojnë dhe t'ia sqarojnë në mënyrë efektive platformat e tyre, publikut.
- Shpërndarja e minutazhit falas mund të bëhet në baza të barabarta ose proporcionale. Kur numri i partive politike konkurruese është i kufizuar, mund të aplikohet një barazi rigoroze.
- Kur numri i partive politike dhe kandidatëve konkurrues është i lartë, mund të miratohet për një formulë proporcionale. Kriteret për përcaktimin e proporcionave mund të bazohen në një sërë njësisht matëse, duke përfshirë votat e marra nga partitë politike në zgjedhjet e mëparshme të të njëjtit lloj, numrin e vendeve që ka në parlament secila parti politike, apo prapen e bazuar në numrin e kandidaturave të paraqitura në një numër minimal zonash zgjedhore.
- Teorikisht, akses i drejtpërdrejtë duhet të jepet kur janë gjasat që të arrihet audiencë më e madhe e mundshme. Gjithashtu, akses i drejtpërdrejtë duhet të jepet mbi baza jodiskriminuese. Për këtë arsye është e papranueshme që mesazhet e disa kandidatëve të transmetohen vetëm vonë gjatë natës apo herët në mëngjes, ndërkohë që kandidatëve të tjerë u jepet minutazh gjatë kohës me audiencën më të madhe (primetime).
- Procesi i shpërndarjes së minutazhit falas duhet të jetë i ndershëm dhe transparent. Radha dhe datat e shfaqjes në transmetim duhet të garantojnë mosdiskriminim të konkurrentëve dhe të përcaktohen me short.
- Respektimi i dispozitave që rregullojnë shpërndarjen e minutazhit falas duhet të monitorohet nga një organ i pavarur, që është në gjendje të trajtojë në mënyrë të efektshme dhe të menjëhershme çdo shkelje.

Media  
elektronike  
private

- Zakonisht, organet e medias elektronike private nuk janë të detyruara t'u japin minutazh falas konkurrentëve në zgjedhje. Megjithatë, kur ata vendosin të ofrojnë minutazh ose kur janë të detyruar me ligj ta bëjnë këtë, ata duhet të ndjekin të njëjtat parime si ato që rregullojnë transmetuesit publikë.



## Reklamata me pagesë

Reklamata politike me pagesë u ofrojnë një tjetër mundësi partive politike dhe kandidatëve për të përçuar mesazhet e tyre përmes medias. Ndonëse zgjedhësit kanë, pa diskutim, nevojë për sa më shumë informacion rreth konkurrentëve, në mënyrë që të jenë të informuar përpara se të bëjnë një zgjedhje, reklama me pagesë mund t'u japë një avantazh të padrejtë atyre partive politike apo kandidatëve që mund të përballojnë blerjen e më shumë minutazhi apo hapësire reklamimi. Ndonëse reklama politike me pagesë pranohet gjerësisht në median e shkruar, disa shtete nuk e lejojnë këtë gjë në median elektronike (qoftë ajo private, publike apo të dyja).

### Reklama me pagesë

Media private / shtetërore	Nëse lejohet reklama me pagesë, ajo duhet të përmbushë disa rregulla bazë:
Media elektronike private	<ul style="list-style-type: none"><li>• Duhet t'u garantohet mbi baza të barabarta të gjithë konkurrentëve duke u ofruar tarifa të qëndrueshme dhe të njëjta;</li><li>• Tarifat për minutazhin zgjedhor me pagesë dhe hapësirat reklamuese nuk duhet të tejkalojnë tarifat e krahasueshme me reklamata tregtare;</li><li>• Media duhet të identifikojë minutazhin e paguar apo hapësirat e sponsorizuara të partive politike, në mënyrë të qartë, me qëllim që t'u japë mundësi zgjedhësve të jenë të vetëdijshëm për natyrën e programit</li></ul>

Mbi sasinë e reklamave të paguara, që partitë politike mund të blejnë dhe/ose mbi sasinë e minutazhit të paguar, që mediave iu lejohet të transmetojnë çdo ditë, mund të vendosen disa kufizime. Një tjetër mënyrë e rregullimit të reklamave politike me pagesë është vendosja e disa kufijve mbi shpenzimet për fushatat zgjedhore të partive politike dhe kandidatëve. Në disa raste, me qëllim konsolidimin e parimit të mundësive të barabarta, shteti mund të lejojë reklama të paguara dhe të vendosë t'i financojë ato pjesërisht.

Media e shkruar private	Çështja e reklamave të paguara nuk është dhe aq problematike për median e shkruar. Megjithatë, media e shkruar duhet të ndjekë parimin e mundësive të barabarta: Reklamata e paguara duhet t'u garantohen mbi baza të barabarta të gjithë konkurrentëve duke iu ofruar tarifa të qëndrueshme dhe të njëjta. Media e shkruar duhet të identifikojë qartë materialet për të cilat është paguar. Mbi sasinë e reklamave të paguara që partitë politike kanë mundësi të blejnë, mund të vendosen disa kufizime ashtu sikurse mund të vendosen kufizime për numrin e faqeve të paguara, që mund të botojë çdo ditë një organ mediatik.
-------------------------	---

## Informimi i zgjedhësve

Programet e edukimit të zgjedhësve, qofshin ato të porositura nga një komision zgjedhor, transmetues publik apo ndonjë organizatë tjetër, duhet të jenë gjithmonë të

paanshme dhe të sakta në informimin e zgjedhësve rreth zgjedhjeve. Këto programe duhet të jenë gjithmonë të ndara qartësisht nga mesazhet politike të njëanshme.

### *Sondazhet*

Është vështirë të matet ndikimi që kanë me të vërtetë sondazhet në rezultatin e zgjedhjeve. Megjithatë, për të shmangur ndikimin e panevojshëm mbi zgjedhësit, media duhet t'i ofrojë publikut informacione të mjaftueshme, që ai të mund të gjykojë vlerën e sondazheve: emrin e partisë apo organizatës që ka porositur një sondazh; emrin e realizuesit të sondazhit dhe metodologjinë e përdorur; madhësinë e kampionit dhe marzhin e gabimit, si dhe datën, në të cilën është zhvilluar sondazhi. Për të shmangur manipulimet e mundshme dhe për të lejuar një periudhë reflektimi, disa vende kanë miratuar dispozita që e ndalojnë shpërndarjen e sondazheve gjatë periudhave të caktuara para ditës së zgjedhjeve apo daljen e sondazheve gjatë orëve të votimit.

### *Periudha e heshtjes*

Periudha e heshtjes, ose siç quhet ndryshe, dita e reflektimit, është një periudhë e shkurtër kohore (zakonisht një ditë), që i paraprin ditës së zgjedhjeve për t'u dhënë mundësi zgjedhësve që të përthithin dhe të përvetësojnë të gjithë informacionin e marrë gjatë fushatës zgjedhore dhe për të bërë një zgjedhje pa presionin e fushatës. Zakonisht ndalohet përçimi apo dhënia e çfarëdolloj mesazhi zgjedhor të njëanshëm gjatë kësaj periudhe.

# Kryerja e Monitorimit të Medias

Në këtë kapitull ofrohet një vështrim të përgjithshëm të metodologjisë që përdoret zakonisht, nga analistët e medias gjatë MVZ-ve. Megjithatë, ai nuk duhet të shihet si një përmbledhje shteruese, ku trajtohet çdo aspekt i krijimit dhe funksionimit të një operacioni për monitorimin e medias; ajo çka ofrohet është shpjegimi i aspekteve më të rëndësishme të kësaj metodologjie për lexuesit e interesuar për këtë aspekt të punës së një misioni zgjedhesh.

## 5.1 Vlerësimi i rolit dhe performancës së medias gjatë zgjedhjeve

Për të prodhuar një vlerësim të besueshëm dhe të saktë të performancës së medias gjatë zgjedhjeve, analistit të medias i duhet t'i përgjigjet shumë pyetjeve të paraqitura më herët në Kapitullin 3. Për të realizuar këtë, puna e analistit të medias mund të ndahet në këto katër detyra kryesore:

- 📌 Studimi i kuadrit ligjor në bashkëpunim të ngushtë me analistin ligjor;
- 📌 Vëzhgimi i peizazhit mediatik;
- 📌 Monitorimi i mbulimit mediatik të fushatës zgjedhore; dhe
- 📌 Monitorimi i ankesave që lidhen me median dhe shkeljet e lirisë së shprehjes, në bashkëpunim të ngushtë me analistin ligjor.

### 5.1.1 Studimi i kuadrit ligjor

Për të kuptuar kuadrin ligjor, analisti i medias, në bashkëpunim të ngushtë me analistin ligjor, studion këto dokumente:

- 📌 Kushtetutën;

- 📌 Ligjin apo kodin zgjedhor;
- 📌 Legjisllacionin për median;
- 📌 Ligjet dhe dispozitat e tjera në kodet penale dhe civile, që lidhen me median;
- 📌 Rregullat dhe rregulloret për mbulimin mediatik, të nxjerra nga administrata zgjedhore;
- 📌 Rregullat dhe rregulloret e nxjerra nga organet e rregullimit të medias; dhe
- 📌 Udhëzimet vetërregulluese, të nxjerra nga shoqatat e gazetarëve apo nga organizata të ngjashme.

Kjo analizë ligjore orientohet nga këto dy objektiva:

- 📌 Përcaktimi i shkallës së përputhshmërisë së kuadrit ligjor me angazhimet e OSBE-së dhe me standardet e tjera ndërkombëtare përkatëse; dhe
- 📌 Përcaktimi i shkallës së koherencës dhe konsistencës së brendshme të të gjithë trupës së përgjithshme të ligjeve dhe rregulloreve për median.

Së bashku me analistin ligjor, analisti i medias bën një vlerësim të përgjithshëm të kuadrit ligjor, që rregullon median. Në çdo rast që ekspertët e MVZ-së identifikojnë mungesa të konsistencës ligjore, hartojnë një sërë rekomandimesh për të inkurajuar përmirësime. Këto rekomandime janë pjesë të raportit përfundimtar, që botohet rreth 8 javë pas zgjedhjeve. Ndonëse një ligj themelor si Kushtetuta duhet të mishërojë angazhimet ndërkombëtare dhe lirinë e shprehjes, ligjet dhe aktet ligjore mund të ndryshojnë nga një vend në tjetrin. Çdo vend ka të drejtën të vendosë se deri në çfarë shkalle kërkon që t'i rregullojë mediat.

Megjithatë, rregullat që përcaktojnë detyrimet e medias, si gjatë një fushate zgjedhore, ashtu edhe gjatë periudhave jozgjedhore, duhet të jenë në përputhje me parimet e lirisë së medias dhe nuk duhet ta kufizojnë median në pavarësinë e saj editoriale. Analisti i medias duhet t'i vlerësojë këto dispozita dhe të përcaktojë se sa mirë respektohen ato. Për të vlerësuar nëse organet e medias dhe aktorët politikë i respektojnë apo jo këto dispozita, duhen kuptuar mirë normat që rregullojnë mediat dhe zgjedhjet në një vend të caktuar. Procesi i vëzhgimit në tërësi duhet ta lehtësojë mbledhjen e provave për çdo shkelje të ligjit. Analisti i medias duhet të regjistrojë të gjitha ankesat e paraqitura nga media apo aktorët politikë në lidhje me lirinë e shprehjes dhe me aksesin në media. Çdo rast që paraqitet duhet të hetohet.

### 5.1.2 Vëzhgimi i peizazhit mediatik

Për të vlerësuar marrëdhënien mes medias dhe sistemit politik gjatë një fushate zgjedhore, analisti i medias duhet të analizojë peizazhin mediatik. Për të parandaluar keqinterpretimet e ngjarjeve apo kushteve të caktuara, analisti i medias duhet të

ndërmarrë një sërë hapash për të kuptuar mjedisin historik, politik, social dhe kulturor të vendit ku zhvillohet vëzhgimi.

Analisti i medias mund të fitojë më shumë njohuri lidhur me peizazhin mediatik dhe kontekstin e tij, përmes takimeve me:

- ✎ Aktorët institucionalë, duke përfshirë përfaqësuesit e ministrisë që përfshin median në fushën e saj të përgjegjësisë, ministrinë e telekomunikacioneve, këshillat e transmetimit dhe organe të tjera të rëndësishme rregullatore të medias, organet e ngarkuara me çështjet që lidhen me median në komisionin zgjedhor etj.;
- ✎ Përfaqësuesit dhe shoqatat e medias së shkruar dhe asaj elektronike, p.sh.: drejtues, redaktorë, gazetarë, përfaqësues të agjencive të lajmeve, shtëpi botuese, shoqata gazetarësh etj.; dhe/ose
- ✎ Organizata kombëtare dhe ndërkombëtare (qeveritare dhe joqeveritare), që operojnë në sektorin e medias, duke përfshirë të gjitha grupet aktive, në mënyrë të përhershme apo të përkohshme, me seli në vendin pritës.

Analisti i medias duhet gjithashtu, të marrë parasysh të dhënat që kanë lidhje me kontekstin, si më poshtë:

- ✎ Numrin e organeve të medias elektronike dhe të shkruar, që operojnë në vend;
- ✎ Llojet e organeve të medias publike/shtetërore, qofshin elektronike apo të shkruara;
- ✎ Numrin e licencave të lëshuara nga shteti, në nivel kombëtar dhe lokal;
- ✎ Numrin e stacioneve të palicencuara, nëse ka të tilla, që operojnë në vend;
- ✎ Mbulimin gjeografik të medias ekzistuese;
- ✎ Klasifikimin sipas audiencës dhe numrit të lexuesve të medias, aty ku bëhen sondazhe institucionale apo profesionale;
- ✎ Orët e transmetimit apo frekuencat e publikimit për çdo organ mediash;
- ✎ Madhësinë e kompanive mediatike;
- ✎ Llojin e medias, audiencat e synuara dhe ndikimi që ato mund të kenë tek publiku;
- ✎ Numrin e organeve të medias, dedikuar minoriteteve të veçanta etnike/gjuhësore, që jetojnë në vend;
- ✎ Kushtet ekonomike të medias, medias së përgjithshme dhe tregut të reklamave, si dhe ekzistencën e subvencioneve të veçanta apo përjashtimet nga taksat;
- ✎ Strukturën dhe transparencën e pronësisë së medias (përqendrimi përkundrejt larmisë);
- ✎ Numrin dhe pronësinë e agjencive të lajmeve dhe shtëpive botuese;
- ✎ Strukturën dhe kontrollin e sistemit të shpërndarjes së medias së shkruar;

- 📌 Kriteret e licencimit për median elektronike;
- 📌 Numrin e organeve mediatike, nëse ka të tilla, që zotërohen ose kontrollohen nga aktorë politikë; dhe
- 📌 Nivelin e aksesit në vend, në mediat e reja dhe në internet.

Një pjesë e këtyre informacioneve mund të merret nga dokumente dhe raporte zyrtare mbi mjedisin e medias, prodhuar nga organizata ndërkombëtare, duke përfshirë Përfaqësuesin e OSBE-së për Lirinë e Medias, prezencën lokale të OSBE-së (nëse ka të tilla), organizatat joqeveritare lokale apo ndërkombëtare, universitetet, shoqatat e gazetarëve ose aktorë të tjerë në terren. Takimet me përfaqësues të medias dhe me ekspertë të tjerë mund të ofrojnë informacion shtesë.

Intervistat me gazetarë dhe profesionistë të tjerë të medias duhet të fokusohen gjithashtu, në temat që lidhen me fushatën, si më poshtë:

- 📌 Opinionet e gazetarëve lidhur me rregullimet ligjore, nëse ka të tilla, në lidhje me mbulimin mediatik gjatë zgjedhjeve;
- 📌 Nëse gazetarët kanë marrë trajnim të veçantë për mbulimin e zgjedhjeve;
- 📌 Si planifikojnë gazetarët t'i mbulojnë ngjarjet zgjedhore;
- 📌 Nëse gazetarët ndeshen me pengesa në punën e tyre, duke përfshirë edhe autocensurën;
- 📌 Llojin e programeve që mediat elektronike kanë në plan të transmetojnë për mbulimin e zgjedhjeve;
- 📌 Në rastet kur lejohet me ligj, bazën mbi të cilën media elektronike vendos t'u ofrojë minutazh kandidatëve;
- 📌 Cilat janë rregullat që rregullojnë reklamën e paguar dhe cilat janë tarifatat që aplikohen;
- 📌 Nëse media ka miratuar ndonjë kod të brendshëm etike apo udhëzues për mënyrën se si duhet t'i mbulojnë gazetarët ngjarjet zgjedhore; dhe
- 📌 Nëse media ka marrë ndonjë ankesë nga partitë politike apo kandidatët, në lidhje me mënyrën se si ato e mbulojnë fushatën.

Vëzhgimet në terren dhe takimet me gazetarë, ekspertë të medias, organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, që punojnë për çështjet e medias dhe të tjerë, i japin mundësi analistit të medias të bëjë një vlerësim të përgjithshëm të nivelit të profesionalizmit dhe autonomisë mes gazetarëve. Nëse gjatë periudhës vëzhguese dalin në pah të meta sa i përket kapacitetit profesional, analisti i medias rekomandon përmirësime në kuadër të raportit përfundimtar, që botohet rreth 8 javë pas përfundimit të procesit zgjedhor

### 5.1.3 Monitorimi i mbulimit mediatik të fushatave zgjedhore

#### *Marrja e kampionëve*

Sa herë që është e mundur, e gjithë periudha e fushatës zgjedhore duhet të monitorohet me qëllim vëzhgimin e respektimit të rregullave që rregullojnë aksesin dhe mbulimin e kandidatëve dhe partive gjatë gjithë procesit zgjedhor.

Duhet vendosur se cilat kanale televizive apo stacione radioje do të monitorohen, cilat gazeta dhe cilat periudha kohore të medias elektronike (vetëm primetime, 24 orë etj.). Ndonëse këto vendime varen nga burimet që misioni ka në dispozicion, kampioni i marrë duhet të ofrojë informacion të besueshëm mbi tendencat e përgjithshme të mbulimit mediatik.

Para se të zgjedhë se cilat organe mediash do të monitorohen, analisti i medias studion mjedisin mediatik. Ky studim përfshin vlerësimin e sa më poshtë:

- 📌 Numrin dhe llojet e organeve të medias, që operojnë në vend;
- 📌 Pronësinë (publike/shtetërore ose private) e organeve të medias;
- 📌 Gamën gjeografike (kombëtare apo lokale) të organeve të medias;
- 📌 Klasifikimin e audiencës/numrit të lexuesve të organeve të medias;
- 📌 Orët e transmetimit ose frekuencën e botimit të organeve të medias;
- 📌 Llojin e medias, audiencën e synuar dhe vlerësimin e ndikimit që ato mund të kenë te publiku dhe tek elita politike; dhe
- 📌 Numrin e organeve të medias, që fokusohen në mënyrë të veçantë te pakicat etnike/gjuhësore, që jetojnë në vend.

Ky informacion i lejon analistit të medias të bëjë sugjerime në lidhje me:

- 📌 **Numrin e organeve të medias që duhen monitoruar:** Analisti i medias i rekomandon kreut të misionit se sa kanale dhe gazeta duhet të vëzhgohen dhe shpjegon arsyet e zgjedhjes së tij. Për të pasur të dhëna të krahasueshme, me përcaktimin e kampionit, është e rëndësishme që t'i përmbahet po atij kampioni dhe të mos modifikohet gjatë rrugës, në periudhën e vëzhgimit të zgjedhjeve;
- 📌 **Fasha kohore e vëzhgimit të medias elektronike:** Periudha bazë që duhet të monitorohet për stacionet televizive dhe ato të radios është gjatë primetime (normalisht 18:00-24:00 për stacionet televizive dhe 6:00-12:00 për radiot) kur audiencat janë normalisht më të larta. Përzgjedhja e orareve që duhet të monitorohen mund të ndryshojë nga një vend, në tjetrin, sipas orareve të programeve të veçanta dhe rregullave që rregullojnë fushatat zgjedhore në media. Megjithatë, çfarëdolloj fashe kohore që të zgjidhet, vëzhgimi nuk duhet të kufizohet në edicionet informative dhe duhet të përfshijë edhe programe të

tjera, që transmetohen në atë fashë kohore. Debatet, programet informative, minutazhi falas dhe programet argëtuese mund të luajnë një rol në formulimin e pikëpamjeve të zgjedhësve dhe partive politike. Për këtë arsye, është e rëndësishme që të monitorohet edhe se sa kohë u jepet konkurrentëve të ndryshëm në këto lloj programesh; dhe

- 📌 **Lloji i organeve të mediave që do të monitorohen:** Kriteret për zgjedhjen e organeve të mediave duhet të marrin parasysh edhe pronësinë e tyre. Mediat me pronësi publike kanë detyrime më të forta sesa ato private, pasi ato financohen me fonde publike dhe, për këtë arsye, nuk duhet të jenë të njëanshme në mbulimin e tyre. Prandaj, është përparësi vëzhgimi i mediave shtetërore apo publike. Analisti i medias duhet të përfshijë në kampionin e tij, organet kryesore të mediave elektronike private, të cilat duhet të zgjidhen në bazë të mbulimit gjeografik, audiencës dhe ndikimit që mund të kenë tek zgjedhësit. Sa i përket medias së shkruar, duhet të monitorohen të gjitha të përditshmet e rëndësishme kombëtare, të zgjedhura në bazë të mbulimit gjeografik, numrit të lexuesve dhe ndikimit që mund të kenë tek lexuesit. Në zonat ku ka popullatë të konsiderueshme minoritare, do të ishte e këshillueshme që të monitorohen organet e vogla mediatike, që mund të kenë ndikim te grupet e pakicave. E njëjta gjë mund të bëhet edhe në rastin e gazetave që kanë tirazh të vogël, por që fokusohen tek elita politike ose sociale, gjë që i bën ato të kenë ndikim në komunitetin më të gjerë të medias.

### *Analiza sasimore*

Monitorimi i mbulimit të një fushate zgjedhore nga media, kërkon mbledhjen e një sërë elementesh sasimore të produkteve mediatike, si p.sh:

- 📌 Sasinë e kohës, kushtuar kandidatëve të caktuar dhe zyrtarëve të tjerë kryesor publikë<sup>5</sup>
- 📌 Minutazhin e transmetimeve zgjedhore të partive politike;
- 📌 Numrin e herëve që përdoret një fjalë e caktuar për të përshkruar një politikan të caktuar;
- 📌 Numrin e grave kandidatë, të përmendura në media; dhe
- 📌 Numrin e herëve që raportohet një çështje e caktuar e fushatës zgjedhore

Ka edhe aspekte të tjera të mbulimit të fushatës zgjedhore nga media, që mund të maten në mënyrë të dobishme:

---

5 Në rastin e një zyrtari publik, që është njëkohësisht edhe kandidat, analisti i medias duhet të përpiqet të bëjë dallimin midis detyrave zyrtare dhe aktiviteteve për fushatë të një kandidati të tillë, gjë që nuk është e lehtë, pasi aktivitetet zyrtare mund të jenë të një rëndësie të vogël, edhe pse të mbuluara gjerësisht në media për t'u ekspozuar edhe më shumë.



- ✎ Numri i herëve që përmendet secili aktor politik (si p.sh.: një kandidat apo politikan tjetër);
- ✎ Minutazhi apo hapësira që i jepet çdo aktori politik;
- ✎ Referencat pozitive, negative apo neutrale, që bëhen ndaj secilit aktor;
- ✎ Koha apo hapësira që u jepet fjalimeve të drejtpërdrejta të çdo aktori politik ose intervistat me ta;
- ✎ Referencat ndaj temave të ndryshme;
- ✎ Radha e vendosjes së kandidatëve, partive apo temave të ndryshme në edicionet informative; dhe
- ✎ Raporti gjinor i mbulimit mediatik të kandidatëve.

Është e rëndësishme të mbahet parasysh që këto të dhëna sasiore i shërbejnë një qëllimi më të madh; këto elemente nuk numërohen thjesht sepse mund të numërohen, por sepse analizimi i këtyre të dhënave në kontekstin e peizazhit mediatik dhe situatës politike, në një fushatë të caktuar zgjedhore, mund ta ndihmojë analistin e medias t'i përgjigjet shumë pyetjeve që ngrihen në Kapitullin 3 rreth rolit të medias në procesin zgjedhor. Gjithashtu, kjo i jep analistit të medias edhe informacionin që i nevojitet për vlerësimin e performancës së medias në fushatë.

Por ky analizim ka kufizimet e veta. Mund të ekzistojë një shpjegim i vlefshëm se përse një kandidati i duhet më shumë kohë se sa një tjetri. Matjet sasiore janë objektive, por të vetme ato mund të mos jenë tërësisht tregues njëanshmërie.

Po kështu, matja e sasisë së kohës nuk na tregon se si është përdorur ajo kohë. Mbulimi mund të jetë pozitiv, negativ ose neutral sa i përket tonit. Për shembull, aktivitetet e zyrtarëve aktualë mund të mbulohen kryesisht nga një këndvështrim pozitiv, duke theksuar shpesh arritjet dhe sukseset e tyre, ndërkohë që ministrat e qeverisë mund të shfaqen në aktivitetet ceremoniale, si hapja e rrugëve apo fabrikave të reja. Nga ana tjetër, mbulimi i kandidatëve të opozitës mund të jetë kryesisht negativ.

Përveç këtyre konstatimeve, ka edhe shumë aspekte të tjera të rëndësishme të mbulimit nga media të zgjedhjeve, që duhen monitoruar, por që nuk mund të analizohen nga ana sasiore. Ja disa shembuj:

- ✎ **Saktësia:** Matja sasiore e tonit tregon nëse referencat ndaj një partie apo kandidati janë pozitive, negative apo neutrale. Megjithatë, kjo në vetvete nuk mund të tregojë nëse media po raporton me saktësi. Raportimi vazhdimisht i pasaktë është një prej mangësive më serioze të mbulimeve të fushatave dhe mund të identifikohet vetëm përmes analizave cilësore. Analisti i medias mund të përdorë një sërë metodash për ta bërë këtë. Rëndësi të veçantë ka krahasimi i mbulimit nga media me vëzhgimet e bëra nga pjesa tjetër e MVZ-ve. Kjo është një mënyrë për të testuar saktësinë e raportimit në media të aktiviteteve, në të cilat mund të kenë marrë pjesë edhe vetë vëzhguesit. Një tjetër metodë e

rëndësishme është krahasimi i mbulimit të të njëjtave aktivitete nga media të ndryshme. Kjo e vetme nuk tregon se cilat media raportojnë në mënyrë të pasaktë, por ekzistenca e mospërputhjeve përbën një tregues të mirë të çështjeve që kanë nevojë për hetime të mëtejshme.

- ✎ **Mosmbulimi:** Raportimi i deformuar bëhet shpesh edhe përmes mosmbulimit të ngjarjeve apo çështjeve të rëndësishme. Analisti i medias përdor metoda të ngjashme për të identifikuar ngjarjet e pambuluara, siç përdor për të vlerësuar saktësinë: krahasimi midis organeve të ndryshme mediatike dhe referenca ndaj pjesës tjetër të MVZ-së;
- ✎ **Gjuha e urrejtjes:** Monitoruesit vëzhgojnë se si e raporton media gjuhën e zemërimit në fushatat zgjedhore. Kjo kërkon një gjykim të mirë të referencave ndaj fjalëve që përdoren realisht, kontekstit, ligjit vendas dhe standardeve etike.
- ✎ **Titujt dhe grafikët çorientues:** Matja e përmbajtjes së artikujve nuk do të mund të çojë gjithmonë në identifikimin e një prej mënyrave më të zakonshme të keqpërfaqësimit të partive dhe kandidatëve në fushatat zgjedhore. Titujt sensacionalë apo që nuk pasqyrojnë me saktësi përmbajtjen e një ngjarjeje, mund të kenë shumë më shumë ndikim sesa vetë ngjarja, sado e saktë që të jetë ajo. Po kështu, lidhja e një ngjarjeje me materiale vizuale, fotografi apo video, që nuk kanë lidhje me të, mund të ketë ndikim, qoftë ky pozitiv apo negativ. Madje, edhe imazhet gjoja neutrale mund të jenë sensitive; dhe
- ✎ **Çështjet etike:** Të gjitha sa më lart janë çështje që lidhen deri në njëfarë mase, me standardin profesional ose etik të gazetarisë. Mund të dalin edhe çështje të tjera, që mund të kërkojnë komente nga misioni. Për shembull, mund të duket së ekziston një marrëdhënie mes mbulimit të favorshëm të fushatës dhe vendosjes së sasive të mëdha të reklamave nga një parti apo kandidat i caktuar. Po kështu, mund të ketë edhe një mjegullim të dallimit mes fakteve dhe komenteve. Rezultatet e sondazheve mund të raportohen në mënyrë joprofesionale ose në një kohë kur janë të ndaluara me ligj. Edhe këto janë çështje cilësore, të cilat nuk mund të diktohen nga analiza sasiore.

### *Analiza cilësore*

Kjo lloj analize ka për qëllim përshkrimin e situatave dhe fenomeneve, për të cilat analizat sasiore janë ose të panevojshme, ose jo efektive, por të rëndësishme për vlerësimin e cilësisë së përgjithshme të mbulimit të fushatës nga media. Analizat cilësore të mbulimit mediatik të proceseve zgjedhore mund të përfshijnë tema të ndryshme, nga të cilat më të zakonshmet janë:

- ✎ **Stili gazetaresk:** A tentojnë gazetarët të përziejnë opinionet dhe faktet gjatë raportimit? A përpiqen gazetarët t'i ofrojnë publikut analiza të thelluara dhe informacion të saktë apo priren të raportojnë në mënyrë sipërfaqësore dhe të paplotë?

- 📖 **Sjellja profesionale e gazetarëve:** A janë gazetarët përgjegjës për ndonjë informacion apo mbulim që është qartësisht i njëanshëm, për raste shpifjeje, për deklarata të njëanshme apo për lajme të pavërteta?
- 📖 **Avantazhi i kandidatëve/partive në pushtet:** A përfitojnë zyrtarët qeveritarë nga avantazhet e tepruara për shkak të mbulimit të zgjeruar të funksioneve të tyre zyrtare? A i mbulon media aktivitetet e tyre në mënyrë jo kritike, duke theksuar vetëm sukseset e arritura dhe duke shpërfillur dështimet?
- 📖 **Axhenda e organeve të medias:** Çfarë temash dhe ngjarjesh mbulohen nga programet kryesore televizive të lajmeve? A mbulon transmetuesi publik tema që favorizojnë një parti të caktuar politike? A përcaktojnë transmetuesit privatë, një axhendë në interes të një partie të caktuar politike?
- 📖 **Heshtja zgjedhore:** A i respektojnë organet e medias, dispozitat për periudhën e heshtjes zgjedhore (nëse kjo parashikohet nga kuadri ligjor vendas)? Nëse jo, cilat janë shkeljet kryesore? Kush duhet të konsiderohet përgjegjës për shkelje të ligjit?
- 📖 **Mostransmetimi i lajmeve:** A është hequr ndonjë pjesë e rëndësishme e lajmeve nga organet e medias, që janë vëzhguar?
- 📖 **Analiza e formateve të përdorura për mbulimin e zgjedhjeve dhe përmbajtjes së tyre:** A ka shembuj të mbulimit novator të zgjedhjeve? A janë prodhuar programe apo artikuj humoristikë? A ka prodhuar media ndonjë program apo ndonjë artikull në gjuhën(t) e pakicave kombëtare? A i trajton media çështjet e pakicave kombëtare? A ka prodhuar media ndonjë program apo artikull që trajton çështjet gjinore?
- 📖 **Të bërit fushatë përmes medias së re:** website, servera me lista email-esh, mesazhe me tekst në telefonat celularë etj.
- 📖 **Rastet e gjuhës së urrejtjes:** A ka ndonjë organ mediash që përhap gjuhën e urrejtjes? Kë kanë në fokus ato?
- 📖 **Shkeljet:** A është shkelur ndonjë nga dispozitat që rregullon median gjatë periudhës zgjedhore?
- 📖 **Mbulimi i administrimit të zgjedhjeve:** A mbulohen aktivitetet e komisioneve zgjedhore? A mbulohen çështjet delikate, që lidhen me administrimin e zgjedhjeve? A nxit mbulimi mediatik besim tek institucionet dhe tek procesi zgjedhor, apo cenon legjitimitetin e tyre?
- 📖 **Edukimi i zgjedhësve:** A ka ndonjë fushatë të veçantë për edukimin e zgjedhësve? Nëse po, a i ofron ajo zgjedhësve informacione të sakta dhe të qarta në lidhje me të drejtën e tyre për të votuar dhe me procedurat e votimit? A i drejtohet ajo audiencave të ndryshme, sidomos kategorive apo grupeve të disavantazuara, që diskriminohen tradicionalisht? A fokusohet fushata në aspekte të veçanta apo në probleme të përhapura në një vend të caktuar?
- 📖 **Mbulimi i sondazheve:** A prodhohet mbulimi mediatik sipas dispozitave vendase, që rregullojnë shpërndarjen publike të sondazheve? A janë kampionët

e përdorur përfaqësues të të gjithë popullsisë? A janë formuluar pyetjet në mënyrë të përshtatshme?

- 📌 **Mbulimi i exitpoll-eve në ato vende ku votimi ndodh në zona të ndryshme kohore:** A ofrohet mbulimi i exitpoll-eve para mbylljes së qendrave të votimit në të gjitha zonat kohore?

Në bazë të analizës së situatës së medias në një vend të caktuar, siç përshkruhet në këtë seksion dhe duke marrë parasysh kontekstin e veçantë ku do të zhvillohen zgjedhjet, analisti i medias harton një formular, i cili u shpërndahet të gjithë monitoruesve të medias dhe plotësohet prej tyre rregullisht. Të dhënat e mbledhura përmes këtij formulari ruhen vazhdimisht, në një bazë të dhënash, të ngritur posaçërisht për këtë qëllim. Garantimi i saktësisë së të dhënave të mbledhura përbën një pjesë themelore të procesit të monitorimit. Për këtë arsye, verifikimet rutinë dhe të përditshme të të dhënave gjatë procesit të monitorimit, janë pjesë e aktivitetit të analistit të medias.

Kur formularët plotësohen nga të gjithë monitoruesit, është e rëndësishme që të shqyrtohen vëzhgimet e tyre dhe të diskutohen gjetjet bashkë me ta. Kjo është një tjetër mënyrë për të shmangur mbështetjen e gjetjeve, thjesht në përshtypje. Krahasimi i vëzhgimeve dhe diskutimi me monitoruesve dhe analistit të medias shërben si tregues i besueshmërisë së sondazhit dhe konsistencës së rezultateve. Diskutime të tilla duhet të bëhen rregullisht dhe duhet të fokusohen te gjetjet kryesore për të garantuar konsistencën, besueshmërinë dhe mbështetjen e tyre. Në këtë aspekt, takimet periodike me monitoruesit e medias mund të zhvillohen sipas një kalendari të përcaktuar nga analisti i medias.

#### **5.1.4 Monitorimi i ankesave që lidhen me median dhe i shkeljeve të lirisë së shprehjes**

Analisti i medias i ruan të dhënat dhe dokumentacionin e të gjitha ngjarjeve që ndikojnë në lirinë e shprehjes, duke përfshirë sa më poshtë:

- 📌 Nëse ka pasur ndonjë pengesë ndaj aktiviteteve të medias;
- 📌 Nëse media ka hasur ndonjë lloj censure të drejtpërdrejtë apo të tërthortë;
- 📌 Nëse media është gjendur nën presionin e drejtpërdrejtë apo të tërthortë të zyrtarëve qeverisës apo partive politike;
- 📌 Nëse organet e medias publike/shtetërore ndodhen nën presionin e nivelit drejtues sa u përket zgjedhjeve editoriale;
- 📌 Nëse organet e medias private ndodhen nën presion nga pronarët e tyre sa u përket zgjedhjeve editoriale;
- 📌 Nëse gazetarët frikësohen apo janë të frikësuar dhe nëse qëllimi i këtij frikësimi është ndërhyrja në aktivitetet e tyre profesionale;
- 📌 Nëse ka pasur raste të vrasjes, ndalimit apo burgimit të gazetarëve;

- ☞ Nëse akuzat e ngritura ndaj organeve mediatike dhe gazetarëve kanë një bazë të shëndoshë ligjore;
- ☞ Nëse ka pasur raste organesh mediatike, që janë mbyllur gjatë fushatës zgjedhore apo para saj;
- ☞ Nëse organeve mediatike u është refuzuar dhënia apo rinovimi i licencës; dhe
- ☞ Nëse organet mediatike kanë marrë pagesa të fshehta për favorizimin e një partie politike apo një kandidati.

Gjatë procesit zgjedhor, kandidatët, partitë politike dhe profesionistët e medias, që janë në shënjestrën e diskriminimit apo shkeljes së të drejtave të tyre, mund të depozitojnë ankesa, me qëllim vënien në vend të të drejtave të tyre. Ruajtja e të dhënave në lidhje me këto ankesa, i jep mundësi analistit të medias të verifikojë se sa nga shkeljet e supozuara janë raportuar, sa prej tyre janë zgjidhur, deri në çfarë mase ka pasur një reagim të menjëhershëm, cilat kanë qenë vendimet e organeve shqyrtuese në secilin rast dhe, në mënyrë më të përgjithshme, si ka funksionuar procesi i ankimit dhe apelimit.

Megjithatë, analisti i medias nuk duhet të ndërhyjë në këtë proces. Për shembull, kur në vend që t'i drejtohen organit kompetent, ankesat i drejtohen MVZ-së, analisti i medias duhet të kufizohet në regjistrimin e ankesës pa ndërhyrë në mosmarrëveshje, duke i kujtuar ankuesit kanalet zyrtare, të cilave duhet t'u drejtohet në këto raste. Ndonëse duhet të vazhdojë të jetë i paanshëm, analisti i medias duhet gjithsesi, të mbledhë sa më shumë informacion në lidhje me një ankesë, në momentin që vihet në dijeni rreth saj. Për të pasur një tablo të plotë të objektit të mosmarrëveshjes, analisti i medias duhet të takohet me të gjitha palët e përfshira. Analisti i medias punon në bashkëpunim të ngushtë me analistin ligjor dhe me analistin e zgjedhjeve.

Ankesat në lidhje me median duhet të mblidhen në formë të shkruar dhe të arkivohen. Ato duhet të klasifikohen në një formular të hartuar posaçërisht për këtë qëllim (në formë fizike ose në version elektronik), të verifikohen dhe të ndiqen sa i përket ecurisë së tyre. Ky formular duhet të përmbajë informacione që kanë lidhje më çështjen, si:

- ☞ Datën e paraqitjes së ankesës;
- ☞ Emrin e ankuesit;
- ☞ Emrin e organit apo personit, ndaj të cilit është depozituar ankesa;
- ☞ Emrin e organit, në të cilin është depozituar ankesa;
- ☞ Vendndodhjen e organit, në të cilin është depozituar ankesa;
- ☞ Vendin ku ka ndodhur problemi i supozuar;
- ☞ Objektin e ankesës;
- ☞ Bazën ligjore, mbi të cilën është drejtuar ankesa;
- ☞ Një koment të shkurtër për ankesën nga ana e analistit të medias ose të vëzhguesit (vëzhguesve) që e kanë raportuar atë; dhe
- ☞ Datën, në të cilën ankesa do të shqyrtohet nga organi kompetent.



# Përpunimi dhe Analizimi i të Dhënave

## 6.1 Njësitë e kontekstit

Monitoruesit punojnë me nënseksione të veçanta të medias që monitorojnë, të njohura si “njësi konteksti”. Njësi konteksti është çdo pjesë e pandërprerë e një transmetimi apo një materiali të botuar, që ka të njëjtën përmbajtje. Njësitë e kontekstit mund të jenë të gjata (për shembull, një program i tërë televiziv apo radiofonik, si: një talkshow apo një program për aktualitetin) ose të shkurtra (siç është një lajm i vetëm si pjesë e edicionit të lajmeve). Në praktikë, fillimi dhe fundi i çdo njësie konteksti dallohen relativisht lehtë. Ato shënohen ose nga fillimi ose nga fundi i një programi, ose në një mënyrë më pak formale, por po aq të dallueshme, nga ndarja midis lajmeve të ndryshme në një edicion lajmesh. Njësitë e kontekstit në median e shkruar janë pothuajse, gjithnjë të ndara në artikuj individualë. Si rregull, reklamat nuk duhet t’i ndërpresin njësitë e kontekstit. Megjithatë, përjashtim nga ky rregull mund të jenë rastet kur reklamat përfshijnë një aktor përkatës, d.m.th. një politikan apo një kandidat. Këto duhen konsideruar si njësi konteksti në vetvete dhe duhet të analizohen veçmas. Njësitë e kontekstit ndahen në njësi regjistrimi, me qëllim matjen e numrit të ndryshoreve. Këto janë elementet që vëzhgohen në procesin e monitorimit të medias, si p.sh.: koha e mbulimit, aktorët e përfshirë dhe toni i mbulimit.

## 6.2 Njësitë e regjistrimit

Njësia e regjistrimit është segmenti i një mesazhi, që i përkushtohet një dhe vetëm një aktori përkatës. Një njësi konteksti (p.sh.: një talkshow) ka po aq njësi regjistrimi sa dhe numri i segmenteve të komunikimit, që i kushtohet aktorëve përkatës individualë. Kështu, për shembull, sa herë flet një kandidat politik gjatë një talkshow, kjo përkufizohet si një njësi regjistrimi më vete. Në lajmet e shkruara, njësi regjistrimi përbën çdo herë që kandidati referohet ose citohet. Avantazhi i përdorimit të segmenteve të vogla të tekstit si njësi regjistrimi, është niveli i saktësisë që kjo mënyrë të lejon gjatë fazës së analizimit. Çdo njësi regjistrimi regjistrohet më vete dhe merr një kod sipas ndryshoreve të shënuara gjatë procesit të monitorimit të medias.

## 6.3 Kodimi

Kodimi i ndryshoreve është vendimtar dhe kodet e caktuara duhet të jenë të qarta dhe të pangatërrueshme. Rëndësi të veçantë kanë ndryshoret e mëposhtme:

📌 **Përkufizimi i aktorëve relevantë:** Konceptet e “politikanëve” dhe “kandidatëve” janë të qarta. Megjithatë, analisti i medias duhet t’u japë monitoruesve të medias udhëzime shumë të qarta për mënyrën se si dhe kur duhet të regjistrohen këto raste, për llogari të ndryshores së aktorit përkatës. Përcaktimi se cilët individë apo grupime duhet të klasifikohen si aktorë përkatës, mund të varet nga lloji i zgjedhjeve. Aktorët përkatës mund të jenë:

- ◆ Të gjithë deputetët;
- ◆ Të gjithë anëtarët e qeverisë (ministrat e zëvendësministrat);
- ◆ Të gjithë kandidatët që kandidojnë në zgjedhje (bazuar në lista zyrtare, të miratuara dhe të publikuara nga autoritetet zgjedhore);
- ◆ Të gjithë aktorët institucionalë (presidenti, kryetari i kuvendit etj.);
- ◆ Të gjithë anëtarët e administratës vendore (kryetarët e bashkive dhe përfaqësuesit e këshillave vendorë);
- ◆ Anëtarët e partive politike, të përcaktuar qartë si politikanë aktivë (p.sh.: kryetari i një partie të regjistruar, që nuk është kandidat në zgjedhje, i cili nuk është anëtar i qeverisë apo i një institucioni tjetër zyrtar dhe që nuk është anëtar i administratës vendore); dhe
- ◆ Të gjitha partitë politike të regjistruara;

Para se të fillojë mbledhja e të dhënave, është e rëndësishme që të merret lista e partive politike dhe/ose kandidatëve dhe përkatësive të tyre partiake, nga administrata kombëtare e zgjedhjeve, si dhe lista e anëtarëve të qeverisë aktuale.

📌 **Përkufizimi i ndryshoreve të përdorura për përshkrimin e aktorëve relevantë:** Analisti i medias duhet të vendosë se sa ndryshore duhet të përdoren për përshkrimin e aktorëve përkatës. Për të regjistruar numrin e rasteve dhe për të prodhuar statistikën e nevojshme, duhet të merren parasysh gjithmonë, tri karakteristika në përshkrimin e aktorëve përkatës: përkatësia politike, kandidatura dhe përkatësia gjinore. Këto ndryshore i japin mundësi ekipit monitorues që të përcaktojë shpërndarjen e mbulimit mes partive politike ose kandidatëve individualë, që kandidojnë në zgjedhje, si dhe të prodhojë të dhëna që lidhen me përkatësinë gjinore. Këtu mund të përfshihen edhe ndryshore të tjera. Për shembull, mund të jetë me interes të dihet se sa shpesh raportohet për kandidatët nga grupet minoritare apo citohen ata.d.

Një vendim i rëndësishëm, që duhet marrë, është se si do të klasifikohen anëtarët e qeverisë. Përfaqësuesit e qeverisë kanë zakonisht, identitet të dyfishtë, në kuptimin që janë edhe anëtarë të një partie politike, edhe përfaqësues të pushtetit ekzekutiv. Në rastet kur anëtarët e pushtetit ekzekutiv janë edhe kandidatë, analisti i medias mund të zgjedhë të regjistrojë rastet ku ata mbulohen në cilësinë e tyre ekzekutive, ndaras nga rastet kur mbulohen në aktivitetet e tyre zgjedhore. Për këtë arsye, i duhet kushtuar vëmendje e veçantë monitorimit të këtij aspekti, pasi është i rëndësishëm sigurimi i të



dhënave mbi mbulimin që u jepet anëtarëve aktualë të qeverisë, për të vlerësuar nëse ata kanë gëzuar një avantazh joproporcional apo jo.

#### 6.4 Sistemi i matjes

Njësitë më të mira të matjes, sa i përket saktësisë, janë sekondat dhe centimetrat katrorë. Nëse ekipi monitorues, thjesht, numëron se sa herë ndodh një njësi konteksti apo mbulimi i një aktori përkatës, pa llogaritur kohëzgjatjen e secilit rast (apo në rastin e medias së shkruar, centimetrat katrorë kushtuar rastit), kjo mund të çojë në rezultate keqorientuese. Nevoja për të pasur një tablo të saktë, të shpërndarjes së mbulimit të partive politike dhe politikanëve, do të thotë që në rastin e medias elektronike matet koha që u jepet, ndërsa në rastin e medias së shkruar matet hapësira.

Matjet e përdorura për llogaritjen sasiore të mbulimit, që i kushtohet aktorëve politikë nga media, janë zakonisht koha e vëmendjes apo hapësira e vëmendjes, ku:

- 📌 Koha totale është matja e mbulimit në televizion apo radio, të një aktori përkatës;
- 📌 Hapësira totale është matja e të gjithë hapësirës së kolonave të mbulimit nga media e shkruar, të një aktori përkatës;
- 📌 Koha totale llogaritet me ndihmën e një kronometri ose të një kohëmatësi në një regjistruar video/dixhital dhe raportohet me sekonda, në kolonën e kohës të formularit të analizës për TV/radio. Hapësira totale llogaritet në centimetra katrorë dhe raportohet në kolonën e hapësirës të formularit të analizës për median e shkruar; dhe
- 📌 Treguesit e kohës për ligjëratat të drejta (në vetë të parë) dhe hapësirës për intervista ndihmojnë në matjen e aksesit të drejtpërdrejtë (në intervista, deklaratat, reklama etj.), që u jepet aktorëve politikë nga media. Koha e ligjëratave të drejta është koha kur aktori politik përkatës citohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, në televizion ose në radio. Hapësira e intervistave është hapësira ku aktori politik citohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, në shtypin e shkruar.

#### 6.5 Cilësia e mbulimit

Mbledhja e informacionit për sasinë e mbulimit, kushtuar aktorëve të ndryshëm politikë, nuk ofron një tablo të plotë të nivelit të pluralizmit që shfaqin organet e medias. Imazhi publik i partive politike, kandidatëve dhe liderëve formohet jo vetëm nga sasia e kohës apo hapësirës që u jepet, por edhe nga mënyra se si portretizohen. Për këtë arsye, monitorimi i saktë i medias kërkon përdorimin e një indeksi të përgjithshëm të cilësisë së mbulimit. Vështirësia e parë është minimizimi i subjektivizmit të gjykimeve nga monitoruesit kur vlerësohet toni i mbulimit, një veçori që nga vetë natyra është subjektive. Trajnimi i monitoruesve vendas të medias është i rëndësishëm për t'iu dhënë atyre udhëzime të qarta sa u përket elementeve që duhet të merren parasysh në vlerësimin e tonit dhe mënyrës si regjistrohet kjo ndryshore. Rregullat për kodifikimin e tonit duhet të përcaktohen në mënyrë të qartë dhe rastet e paqarta duhet të diskutohen me shumë kujdes.

Matja e cilësisë së mbulimit bazohet në një sërë karakteristikash që mund të përkthehen në ndryshore, duke përfshirë:

- 📌 Gjykimet e qarta, të bëra nga gazetari rreth një aktori të caktuar;
- 📌 Korniza e mbulimit të një aktori përkatës. Korniza përfshin vlerën e lajmeve, në kuadrin e të cilave mbulohet aktori, d.m.th. konteksti në të cilin bëhet raportimi mbi aktorin përkatës. Prandaj korniza nuk lidhet me të vërtetën apo të pavërtetën e kontekstit, por me këndvështrimin, në të cilin ky kontekst mbulon aktorin përkatës. Mbulimi i vazhdueshëm i një aktori politik në kontekste problematike (episode dhune, gjyqe për korrupsion etj.) gjatë një fushate zgjedhore, mund të përbëjë një përpjekje për t'i dhënë publikut një vlerësim negativ të atij aktori;
- 📌 Përdorimi manipulues i filmimeve, fotografimeve dhe zërave në përpjekje për të ndikuar opinionin e zgjedhësit (deputet duke fjetur, kënde filmimi që tregojnë grumbullime të mëdha njerëzish, reklamimet e pavetëdijshme);
- 📌 Zgjedhja e fjalëve në mbulimin e aktorëve politikë apo në raportimin e lajmeve; si dhe
- 📌 Respektimi i standardeve profesionale bazë të gazetarisë si dallimi mes lajmit dhe komentit, dhe korrigjimi i informacioneve të pasakta në mbulimin e lajmeve të ndryshme.

Toni matet zakonisht, duke përdorur një shkallë që përfshin pesë vlera (shumë negativ, negativ, neutral, pozitiv, shumë pozitiv) ose tre (pozitiv, neutral, negativ).

## 6.6 Peshimi i rasteve

Analisti i medias është i interesuar jo vetëm të kontrollojë se sa herë shfaqen apo përmenden aktorët përkatës, por edhe të vëzhgojë se për sa kohë ata janë fokusi i vëmendjes së një raportimi. Analisti i medias duhet të jetë në gjendje të thotë se sa kohë apo se sa hapësirë i është kushtuar një partie politike dhe jo thjesht, të thotë se sa herë janë përmendur (frekuencën).

Frekuenca e përmendjeve duhet të peshohet në raport me kohën apo hapësirën e kushtuar. Veçanërisht e dobishme është llogaritja e përqindjes relative të kohës së mbulimit apo hapësirës së dhënë, pasi frekuenca në vlera absolute nuk lejon menjëherë krahasimin e nivelit të mbulimit që u jepet aktorëve të ndryshëm.

Llogaritja e vlerave në përqindje i lejon analistit të medias që të krahasojë shpërndarjen e kohës/hapësirës mes aktorëve të ndryshëm.

## Shembull

Përkatësia politike	Koha	Koha në %
Partia 1	631	46.2%
Qeveria	317	23.2%
Partia 3	286	20.9%
Institucionale	133	9.7%
Totali	1,367	100%

Kjo qasje i lejon analistit të medias të raportojë se Partia 1 ka marrë pjesën më të madhe të mbulimit ose më shumë se dyfishin e mbulimit të marrë nga Partia 3.

### 6.7 Interpretimi i të dhënave

Të dhënat numerike duhet të interpretohen me kujdes, duke marrë parasysh jo vetëm çfarë tregojnë statistikën, por edhe arsyet që mund të qëndrojnë pas këtyre vlerave. Analisti i medias duhet jo vetëm të përshkruajë fenomenin/mbulimin dhe tonin e medias, por edhe të përpiqet ta shpjegojë. Nuk ka ndonjë model të përgjithshëm për interpretimin e të dhënave, por qasjet e mëposhtme mund të ndihmojnë për përmirësimin e leximit dhe interpretimin e të dhënave:

- Kur analizohen të dhënat, është e rëndësishme të lexohen si vlerat absolute, ashtu edhe ato relative, pasi secila prej tyre jep informacion të rëndësishëm. Përdorimi vetëm i vlerave relative, siç janë përqindjet, mund që ndonjëherë të jetë keqorientues. Le të marrim për shembull një rast ku janë tre parti. Partia A ka marrë 5 sekonda mbulim, Partia B ka marrë 2 orë, kurse Partia C 4 orë. Nëse raportojmë vetëm se 70% e kohës së kushtuar Partisë A ishte negative, pa marrë parasysh se shumica e të gjithë kohës së kushtuar asaj ishte shumë e vogël, krahasuar me atë të partive të tjera, rrezikojmë që të mbivlerësojmë rëndësinë e të dhënave.
- Nëse aktivitetet e analizimit të medias gjenerojnë të dhëna apo vlera që duken të çuditshme apo të pasakta, analisti i medias duhet të përpiqet të gjejë edhe shkakun apo shkaqet. Pasaktësitë mund të vijnë si rezultat i gabimeve në fazën e hedhjes apo regjistrimit të të dhënave të monitorimit. Megjithatë, të dhënat mund të jenë të sakta dhe, në këto raste, analisti i medias duhet të jetë në gjendje të shpjegojë anomali të dukshme.
- Duhet përdorur grupe të dhënash, që janë aq të mëdha sa të kenë kuptim. Periudha bazë e raportimit është e gjithë fushata, kështu që analisti i medias duhet të mos nxjerrë përfundime nga të dhënat që mbulojnë periudha të shkurtra kohore.
- Analizimi duhet të krahasojë vetëm rastet e ngjashme dhe jo të “përziejë mollët me portokallet”. Për shembull, krahasimi i produktit të një publikimi

të përditshëm me atë të një publikimi javor, me shumë gjasë do të gjenerojë rezultate të pazakonta dhe keqorientuese. Zakonisht, e përjavshmjia ka më pak artikuj dhe këto artikuj mund të jenë shumë të ndryshëm nga natyra, prej artikujve që publikohen në mënyrë të përditshme. Për shembull, një reportazh i gjatë mund të përmbajë më shumë burime se sa një lajm i shkurtër. Kjo nuk e bën atë domosdoshmërisht artikull më të mirë. Analisti duhet të kujdeset që të mos bëjë krahasime keqorientuese.

- ✎ Është e rëndësishme që, në vlerësimin e të dhënave, informacioni të merret parasysh brenda kontekstit. Normat ligjore, që rregullojnë funksionimin e medias gjatë zgjedhjeve, si legjisllacioni vendas dhe standardet ndërkombëtare, ofrojnë një kuadër themelor për interpretimin e gjetjeve. Sistemi partiak, konteksti politik, rëndësia dhe statusi relativ i organeve të monitoruara të medias përbëjnë elemente të tjera, që duhen të merren parasysh në hartimin e përfundimeve;
- ✎ Kini parasysh se shifrat në tabela apo baza të dhënash janë përshkruese dhe jo në trajtë përfundimesh, pra, ato përshkruajnë vetëm artikujt e monitoruar. Është e pamundur që të përdoren për të dalë në përfundimin se çfarë përmbajtjeje mund të kenë pasur organet e tjera mediatike, që nuk janë monitoruar. Analisti i medias duhet të jetë gjithmonë i kujdesshëm që të mos konsiderojë si fakte, ato që bazohen në gjetje statistikore që nuk janë të përligjura;
- ✎ Gjetjet cilësore ofrojnë shpjegime të dobishme për të dhënat statistikore. Faktorët që qëndrojnë pas një tendence të caktuar, një vlere specifike të konstatuar apo një luhatjeje kuptimplote të të dhënave, mund të identifikohen shpesh duke përdorur analizat e strukturuar cilësore, që bëhen gjatë monitorimit;
- ✎ Të dhënat sasiore duhet të analizohen gjithmonë duke iu referuar se çfarë ka ndodhur në fushatë në atë kohë. Analisti i medias duhet të mbajë gjithmonë parasysh ngjarjet dhe faktorët në botën e jashtme, që mund të shpjegojnë të dhënat, sidomos nëse disa nga rezultatet kanë qenë befasuese. Në periudha më të shkurtra, një ngjarje madhore apo lajm i rëndësishëm mund të ndryshojë ndjeshëm të dhënat; dhe
- ✎ Gjetjet nga monitorimi i medias nuk na tregojnë se çfarë ka ndodhur. Ato na tregojnë vetëm se çfarë është mbuluar nga media. Të dhënat mund të përdoren për të krahasuar rezultatin e organeve të ndryshme mediatike, por, në vetvete, nuk mund të na tregojnë nëse raportimi i medias ka qenë apo jo i saktë. Për të përcaktuar nëse mbulimi ka qenë i saktë, analistit të medias i duhet të krahasojë të dhënat në media me të dhënat rreth incidenteve të raportuara. Kjo mund të përfshijë statistika lidhur me dhunën politike, numrin e mitingjeve për parti të ndryshme etj.

# SHTOJCË

## Përmbledhje e Standardeve dhe Parimeve për Lirinë e Shprehjes gjatë Zgjedhjeve

### *Lista e shkurttimeve*

KSHP:	Komonuelthi i Shteteve të Pavarura	ZKLKB:	Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara
KiE:	Këshilli i Evropës	OSBE:	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
KEDNJ:	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut	APKiE:	Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës
GJEDNJ:	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut	DUDNJ:	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
BE:	Bashkimi Evropian	OKB:	Organizata e Kombeve të Bashkuara
KKMPK:	Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare	KV:	Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias)
KP:	Komente të Përgjithshme		
PNDPCP:	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike		

Kjo shtojcë përmban dokumente me shtrirje gjeografike dhe natyrë të ndryshme që dallojnë nga njëri-tjetri nga shkalla e detyrimit për vende të ndryshme, por, që të gjitha trajtojnë kryesisht, lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias në kontekstin e zgjedhjeve dhe të jetës politike. Kjo listë nuk përfshin dokumente të tjera që lidhen me rolin më të gjerë të medias në jetën sociale dhe politike.

Disa nga këto dokumente janë miratuar nga Kombet e Bashkuara, duke u dhënë atyre një dimension universal dhe një shkallë të lartë mbështetjeje nga shtete të ndryshme. Të tjerat kanë dimension rajonal, pasi janë hartuar dhe miratuar nga organizata rajonale. Kjo shtojcë paraqet kryesisht, standardet e OKB-së, OSBE-së, KSHP-së, KiE-s dhe BE-së, pasi këto janë parimet kryesore, të cilat zbatohen në të gjitha ose në disa prej shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së.

Këto dokumente ndryshojnë nga njëri-tjetri dhe për nga shkalla dhe natyra e të qenit detyruese; disa janë ligjërisht detyruese për qeveritë që i kanë ratifikuar, ndërsa disa të tjera janë politikisht detyruese për qeveritë që janë angazhuar t'i respektojnë ato. Për shembull, PNDPCP-ja është e detyrueshme me ligj, ndërsa angazhimet e OSBE-së janë të detyrueshme politikisht. Rezolutat ose rekomandimet e organizatave ndërqeveritare janë tregues i prirjeve të reja të së drejtës ndërkombëtare dhe praktikave të mira të shteteve. Në fund, kjo shtojcë përfshin edhe disa komente të përgjithshme, të bëra nga organe që monitorojnë traktatet e të drejtave të njeriut, duke i përshkruar hollësisht interpretimet e dispozitave të ndryshme të traktateve përkatëse dhe parimeve të sanksionuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

## Standardet

### Universale

#### ◆ PNDKP-ja e vitit 1966

##### *Neni 19*

1. Secili duhet të ketë të drejtën e mendimit pa asnjë ndërhyrje.
2. Secili duhet të ketë të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacioneve dhe ideve të të gjitha llojeve, pavarësisht nga kufijtë, qoftë me gojë, me shkrim, në formë të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur prej tij.
3. Ushtrimi i lirive të parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, nënkupton detyra dhe përgjegjësi të posaçme. Për rrjedhojë, ai mund t'u nënshtrohet disa kufizimeve, të cilat duhet të përcaktohen shprehimisht me ligj dhe të jenë të domosdoshme:
  - (a) Për respektimin e të drejtave ose të reputacionit të të tjerëve;
  - (b) Për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, të rendit publik, të shëndetit ose të moralit publik.

### Rajonale

#### ◆ Konventa e Komunitetit të Shteteve të Pavarura për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore, e vitit 1995

##### *Neni 11*

1. Çdo person ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e të pasurit të mendimit dhe të marrjes e dhënies së informacioneve dhe ideve, përmes mënyrave të ligjshme, pa ndërhyrje nga autoritetet publike dhe pavarësisht kufijve.
2. Ushtrimi i këtyre lirive, duke qenë se mbart në vetvete detyra dhe përgjegjësi, mund t'i nënshtrohet formaliteteve si kushte dhe kufizime të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, sigurisë së publikut apo rendit publik, apo për qëllime të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

#### ◆ Konventa e Komonuelthit të Shteteve të Pavarura për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore (1995)

### **Neni 11**

1. Çdo person ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e të pasurit të mendimit dhe të marrjes e dhënies së informacioneve dhe ideve, përmes mënyrave të ligjshme, pa ndërhyrje nga autoritetet publike dhe pavarësisht kufijve.

2. Ushtrimi i këtyre lirive, duke qenë se mbart në vetvete detyra dhe përgjegjësi, mund t'i nënshtrohet formaliteteve si kushte dhe kufizime të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, sigurisë së publikut apo rendit publik, apo për qëllime të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

### **◆ Konventa për Standardet e Zgjedhjeve Demokratike, të Drejtat dhe Liritë Zgjedhore në Shtetet Anëtare të Komonuelthit të Shteteve të Pavarura, e vitit 2002**

#### ***Neni 7 Zgjedhjet e Lira dhe Publike***

(...)

4. Brenda periudhës së parashikuar nga ligji zgjedhor, organet e zgjedhjeve publikojnë zyrtarisht, informacionin rreth pjesëmarrjes në votime dhe për personat e zgjedhur në organet e veta ose në organet e tjera mediatike.

#### ***Neni 9 Zgjedhjet e vërteta***

(...)

3. Në zgjedhje të vërteta, zgjedhësit kanë akses të lirë në informacionin rreth kandidatëve, listave të kandidatëve, partive politike (koalicioneve), procesit zgjedhor dhe kandidatëve, partive politike (koalicioneve) – në mjetet e komunikimit masiv të informimit dhe telekomunikacionit.

#### ***Neni 10 Zgjedhjet e ndershme***

1. Respektimi i parimit të zgjedhjeve të ndershme duhet të garantojë kushte të barabarta ligjore për të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor.

2. Zgjedhjet e ndershme garantojnë:

(...)

(b) mundësi të barabarta pjesëmarrjeje për çdo kandidat dhe çdo parti politike (koalicion) në një fushatë zgjedhore, duke përfshirë aksesin në mjetet e komunikimit masive të informacionit dhe telekomunikacionit;

#### ***Neni 13 Mbështetja me Informacion e Zgjedhjeve dhe Fushatave Zgjedhore nga Shteti***

1. Palët garantojnë lirinë për të kërkuar, për të mbledhur dhe për të shpërndarë informacione rreth zgjedhjeve, kandidatëve dhe mbulimit të paanshëm me informacion të zgjedhjeve në masmediat e informimit dhe telekomunikacionit.

2. Mjetet e komunikimit masiv të informimit dhe telekomunikacionit u kërkohet që ta informojnë popullatën rreth zgjedhjeve, caktimit të kandidatëve (listës së kandidatëve), programeve (platformave) të tyre zgjedhore, ecurisë së një fushate zgjedhore, pjesëmarrjes në votim dhe rezultateve të zgjedhjeve brenda kuadrit të kushtetutës, legjislacionit dhe detyrimeve ndërkombëtare të shtetit.

3. Në përputhje me ligjin, anëtarët e shtypit që përfaqësojnë mjetet e komunikimit masiv të informacionit dhe telekomunikacionit, mund:

(a) të marrin pjesë në takime të organeve zgjedhore dhe të garantojnë publicitetin dhe transparencën e këtyre aktiviteteve;

(b) të shqyrtojnë dokumentet dhe materialet e organeve zgjedhore që lidhen me pjesëmarrjen në votim ose me rezultatet e zgjedhjeve, të bëjnë kopje të këtyre dokumenteve dhe materialeve dhe të marrin kopje të tyre nga organet zgjedhore, t'ua përcjellin ato mjeteve të komunikimit masiv të informacionit dhe telekomunikacionit për publikim;

(c) të marrin pjesë në ngjarje publike të fushatave dhe t'i mbulojnë ato në masmedia;

(d) të jenë të pranishëm në votim, në numërimin e votave, në përcaktimin e pjesëmarrjes në votim dhe në shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve.

4. Qytetarëve, kandidatëve, partive politike (koalicioneve) që kanë emëruar një kandidat dhe/ose një listë kandidatësh, shoqatave të tjera publike dhe organizata publike duhet t'u garantohet liria e bërjes fushatë në të gjitha format e lejuara me ligj dhe me metoda të ligjshme, sipas procedurave dhe brenda periudhave kohore, të parashikuara me ligj, në kushtet e pluralizmit të mendimit dhe pa censurë.

5. Në përputhje me kushtetutën, legjislacionin, të gjithë kandidatët, të gjitha partitë politike (koalicionet), të cilat marrin pjesë në zgjedhje, duhet të kenë mundësi të barabarta aksesit në mjetet e komunikimit masiv informacionit dhe telekomunikacion, duke përfshirë edhe aksesin për prezantimin e programeve (platformave) të tyre zgjedhore.

6. Gjatë fushatave zgjedhore nuk duhet të lejohet asnjë shpërdorim i lirisë së shprehjes dhe lirisë së masmediave të informacionit, duke përfshirë thirrjet për ardhje të dhunshme në pushtet, ndryshimet e dhunshme të sistemit kushtetues dhe shkeljen e integritetit territorial të një shteti, nxitjet për luftë, thirrjet për akte terroriste apo akte të tjera të dhunshme që nxisin urrejtjen dhe armiqësinë sociale, racore, kombëtare, etnike dhe fetare.

7. Mjetet e komunikimit masiv të informacionit dhe telekomunikacionit të çdo shteti anëtar të kësaj konvente nuk duhet të përdoren për pjesëmarrjen në fushata kur zgjedhjet mbahen në territorin e një shteti tjetër.

8. Lista e shkeljeve të kushteve dhe procedurave të fushatave të realizuara nga kandidatët, partitë politike (koalicionet) dhe kundërvajtjet në mbulimin e fushatave zgjedhore nga masmedia, që përbëjnë shkaqe për vënien e shkelësve përpara përgjegjësisë, duhet të përcaktohen me ligj.



## ***Neni 19 Detyrimet e Shteteve Anëtare të Konventës***

(...)

2. Palët marrin përsipër:

(...)

(g) të lehtësojnë formimin e partive politike dhe aktivitetin të tyre të lirë dhe legjitim; të rregullojnë në mënyrë legjislative financimin e partive politike dhe proceseve zgjedhore; të garantojnë që ligji dhe politikat vendase të parashikojnë ndarjen e partisë nga shteti dhe që fushatat zgjedhore të mbahen në një atmosferë lirie dhe ndershmërie, që u lejon partive dhe kandidatëve të paraqesin lirisht pikëpamjet dhe opinionet e tyre politike, programet (platformat) e tyre zgjedhore dhe që iu lejojnë zgjedhësve të njihen me to, t'i diskutojnë dhe të votojnë "pro" ose "kundër" lirisht, pa pasur asnjë frikë se mund të ndëshkohen apo përndiqen.

(h) të marrin masa që garantojnë mbulimin e paanshëm të fushatave zgjedhore nga masmedia, duke përfshirë edhe mbulimin nga interneti, duke e bërë të pamundur krijimin e pengesave ligjore dhe administrative, që nuk u lejojnë partive politike dhe kandidatëve të përfitojnë akses në masmedia pa diskriminim (...);

(i) të miratojnë programe kombëtare të edukimit të qytetarëve, të pjesëmarrjes së tyre në hartimin dhe miratimin e programeve të ngjashme ndërkombëtare; të marrin masa për njohjen e qytetarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në zgjedhje, si dhe t'i edukojnë ata në lidhje me procedurat dhe rregullat zgjedhore për të zgjeruar kulturën e tyre ligjore dhe për të përmirësuar kualifikimet profesionale të zyrtarëve të zgjedhjeve;

## **◆ Këshilli i Evropës: Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, e vitit 1950**

### ***Neni 10***

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide, pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon shtetet që të kërkojnë licencimin e ndërmarrjeve të transmetimit, kinematografike ose televizive.

2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

◆ **Këshilli i Evropës: Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, e vitit 1995**

*Neni 9*

1. Palët angazhohen të pranojnë se e drejta e lirisë së shprehjes së çdo personi që i përket një pakice kombëtare përfshin lirinë për të pasur mendime, dhe për të marrë dhe shpërndarë informacione e ide në gjuhën e pakicës, pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pavarësisht nga kufijtë. Palët do të sigurojnë, brenda kuadrit të sistemeve të tyre ligjore, që personat që i përkasin një pakice kombëtare nuk diskriminohen lidhur me raportet e tyre me shtypin.

## Angazhime Politike

### Universale

◆ **Neni 19 i DUDNJ-së, e vitit 1948**

Neni 19. Secili ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacionit dhe ideve me çfarëdo mjetesh, pa marrë parasysh kufijtë.

### Rajonale

◆ **Dokumenti i Takimit të Kopenhagenit i Konferencës së OSBE-së për Dimensionin Njerëzor, i vitit 1990**

*Paragrafi 7*

(...)

(7.8) do të kujdesen që të mos ketë asnjë pengesë ligjore ose administrative për aksesin e lirë në media, mbi baza jodiskriminuese, e të gjitha grupimeve politike dhe individëve, që kanë dëshirë të marrin pjesë në procesin zgjedhor;

*Paragrafi 9*

(9) Shtetet pjesëmarrëse rikonfirmojnë se

(9.1) kushdo ka të drejtën e lirisë së shprehjes, përfshirë dhe të drejtën të komunikimit. Në këtë të drejtë përfshihet liria e mendimit dhe e marrjes dhe përhapjes së informacioneve

dhe ideve, pavarësisht kufijve, pa ndërhyrjen e autoritetit publik. Ushtrimi i kësaj të drejte mund të jetë objekt vetëm i atyre kufizimeve, që përcakton ligji dhe që janë në pajtim me standardet ndërkombëtare. Në veçanti, asnjë kufizim nuk vendoset ndaj aksesit dhe përdorimit të mjeteve për riprodhimin e dokumenteve të çdo lloji, duke respektuar, sidoqoftë, të drejtat lidhur me pronësinë intelektuale, përfshirë dhe të drejtën e autorit; (...)

#### **Paragrafi 10**

((10.1) të respektojnë të drejtën e çdo personi, më vete apo së bashku me të drejta të tjera, për të kërkuar, për të marrë dhe për të përhapur lirisht, pikëpamje dhe informacione mbi të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, përfshirë dhe të drejtat e shpërndarjes dhe publikimit të këtyre pikëpamjeve dhe informacioneve;

#### **◆ OSBE: Karta e Parisit për një Evropë të re, e vitit 1990**

##### ***Të Drejtat e Njeriut, Demokracia dhe Sundimi i Ligjit***

(...)

Qeveritë demokratike bazohen tek vullneti i popullit, i shprehur rregullisht përmes zgjedhjeve të lira dhe të ndershme. Demokracia ka në themel respektimin e personit dhe sundimin e ligjit. Demokracia është garancia më e mirë e lirisë së shprehjes, tolerancës së të gjitha grupeve të shoqërisë dhe barazisë së mundësive për çdo person.

#### **◆ Dokumenti i Takimit të Moskës i Konferencës së OSBE-së për Dimensionin Njerëzor, i vitit 1991**

##### **Paragrafi 26**

Shtetet pjesëmarrëse riafirmojnë të drejtën për lirinë e shprehjes, përfshirë dhe të drejtën e komunikimit dhe të drejtën e medias për të mbledhur, raportuar dhe përhapur informacione, lajme dhe opinione. Çdo kufizim ndaj ushtrimit të kësaj të drejte duhet të përcaktohet me ligj dhe në pajtim me standardet ndërkombëtare. Më tej, shtetet çmojnë se mediat e pavarura janë thelbësore për një shoqëri të lirë dhe të hapur dhe sisteme të përgjegjshme të qeverisjes, dhe kanë rëndësi të veçantë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe liritë themelore.

(26.1) Shtetet vlerësojnë se media e shkruar dhe audiovizive në territorin e tyre duhet të gëzojë akses të pakufizuar në lajmet e huaja dhe shërbimet e informacionit. Publiku duhet të gëzojë liri të ngjashme për të marrë dhe përcjellë informacion dhe ide pa ndërhyrjen e autoritetit publik, pavarësisht kufijve, përfshirë dhe përmes botimeve të huaja dhe transmetimeve të huaja. Çdo kufizim ndaj ushtrimit të kësaj të drejte duhet të përcaktohet me ligj dhe në pajtim me standardet ndërkombëtare.

(26.2) Shtetet pjesëmarrëse nuk do të diskriminojnë mediat e pavarura sa i takon dhënies së aksesit ndaj informacionit, materialeve dhe mjediseve.

#### ◆ OSBE: Deklarata e Samitit të Stambollit, e vitit 1999

##### *Karta për Sigurinë Evropiane*

26. Ne riafirmojnë rëndësinë e medias së pavarur dhe përcjelljen e lirë të informacionit, si dhe aksesin e publikut ndaj informacionit. Ne angazhohemi të marrim të gjithë hapat e nevojshëm për të garantuar kushtet bazë për mediat e lira dhe të pavarura dhe përcjelljen e lirë ndërkufitare dhe ndërshtetërore të informacionit, që ne konsiderojmë se është një komponent thelbësor i çdo shoqërie demokratike, të lirë dhe të hapur.

#### ◆ Deklarata e Samitit të Stambollit

27. Zotohemi të garantojmë lirinë e medias si një kusht bazë për shoqëritë pluraliste dhe demokratike. Jemi thellësisht të shqetësuar rreth shfrytëzimit të medias në zonat e konfliktit për të nxitur urrejtje dhe tensione etnike dhe rreth përdorimit të kufizimeve të ligjshme dhe ngacmimeve për t'i privuar shtetasit nga një media e lirë. Theksojmë nevojën për sigurimin e lirisë së shprehjes, që është një element thelbësor i ligjëritimit politik në çdo demokraci. Mbështesim Zyrën e Përfaqësuesit për Lirinë e Medias, në përpjekjet e saj për nxitjen e medias së lirë dhe të pavarur.

## Komente të Përgjithshme

#### ◆ Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut: Komenti i Përgjithshëm nr. 25: E drejta për të marrë pjesë në çështjet publike, të drejtat e votimit dhe e drejta për akses të barabartë në shërbimin publik, e vitit 1996

##### *Paragrafi 12*

Liria e shprehjes, grumbullimit dhe organizimit janë kushte të domosdoshme për ushtrimin e efektshëm të së drejtës për të votuar dhe duhet të mbrohen plotësisht. Duhet të merren masa pozitive për kapërcimin e vështirësive të veçanta, si: analfabetizmi, pengesat gjuhësore, varfëria apo pengesat ndaj lirisë së lëvizjes, që nuk i lejojnë personat që përbushin kriteret për të votuar, të ushtrojnë të drejtat e tyre në mënyrë të efektshme. Informacionet dhe materialet rreth votimit duhet të ofrohen në gjuhët e pakicave. Metoda të veçanta, si: fotografitë dhe simbolet, duhet të miratohen për t'u siguruar që zgjedhësit analfabetë të kenë informacionin e nevojshëm, mbi bazën e të cilit ata të mund të zgjedhin.

◆ **Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut:  
Komenti i Përgjithshëm nr. 10: liria e shprehjes, i vitit 1983**

1. Paragrafi 1 kërkon mbrojtjen e “së drejtës për të pasur opinione pa ndërhyrje”. Kjo është një e drejtë, ndaj së cilës Konventa nuk lejon asnjë përjashtim apo kufizim. (...)

2. Paragrafi 2 kërkon mbrojtjen e të drejtës së lirisë së shprehjes, e cila përfshin jo vetëm lirinë për të “dhënë informacione dhe ide të të gjitha llojeve”, por edhe lirinë për të “kërkuar” dhe “për t’i marrë ato” pavarësisht “kufijve” dhe në çfarëdo lloji mjeti komunikimi, “qoftë verbalisht, me shkrim apo në shtypin e shkruar, në formën e artit, apo përmes çdo mjeti komunikimi tjetër që ai mund të zgjedhë”. Jo të gjitha shtetet palë kanë ofruar informacion në lidhje me të gjitha aspektet e lirisë së shprehjes. Për shembull, pak vëmendje i është kushtuar deri tani faktit që për shkak të zhvillimit të mjeteve moderne të komunikimit masiv duhen marrë masa të efektshme për të mos lejuar ndërhyrjen e këtij kontrolli të medias në të drejtën e secilit për lirinë e shprehjes, në mënyra që nuk parashikohen në paragrafin 3.

3. Shumë raporte shtetesh kufizohen në përmendjen e faktit që liria e shprehjes garantohet me Kushtetutë ose me ligj. Megjithatë, për të njohur regjimin e saktë të lirisë së shprehjes me ligj dhe në praktikë, Komiteti ka nevojë për informacione të tjera në lidhje me rregullat që ose përcaktojnë objektin e lirisë së shprehjes, ose parashikojnë kufizime të caktuara, si dhe me çdo kusht tjetër, që ndikon në praktikë, në ushtrimin e kësaj të drejte. Është pikërisht ndërveprimi midis parimit të lirisë së shprehjes dhe këtyre kufizimeve, që përcakton shkallën reale të kësaj të drejte individuale.

4. Paragrafi 3 thekson shprehimisht se ushtrimi i së drejtës së lirisë së shprehjes mbart në vetvete, detyra dhe përgjegjësi të posaçme dhe se për këtë arsye mbi këtë të drejtë mund të lejohen disa kufizime që mund të lidhen ose me interesin e personave të tjerë ose me atë të komunitetit në tërësi. Megjithatë, kur një shtet palë vendos kufizime mbi ushtrimin e lirisë së shprehjes, këto kufizime nuk mund të rrezikojnë vetë të drejtën. Paragrafi i tretë përcakton kushtet, si rrjedhojë kufizimet mund të vendosen vetëm duke iu nënshtuar këtyre kushteve: kufizimet mund të “parashikohen me ligj”; ato mund të vendosen vetëm për një nga qëllimet e parashikuara në nënparagrafët (a) dhe (b) të paragrafit 3, dhe duhet të arsyetohen si “të nevojshme” për atë shtet palë apo për një prej këtyre qëllimeve.

## Të Tjera

### Universale

◆ **Rezoluta A/RES/55/96 (2001) e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së – Nxitja dhe Konsolidimi i Demokracisë, e vitit 2001**

(iv) Duke garantuar, përmes legjislationit, institucioneve dhe mekanizmave, lirinë e krijimit të partive politike demokratike, që mund të marrin pjesë në zgjedhje, si dhe transparencën dhe ndershmërinë e procesit zgjedhor, përfshirë sanksionimin e përshtatshëm me ligj për aksesin në media të lira, të pavarura dhe pluraliste;<sup>6</sup>

◆ **Raportet e Raportuesit të Posaçëm të OKB-së për nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtës së lirisë së mendimit dhe lirisë së shprehjes (1999-2009)**

- E drejta e lirisë së mendimit dhe shprehjes së tij, si dhe të drejtat që lidhen me të për lirinë e organizimit dhe tubimit janë të drejta themelore të njeriut, që kanë ndikim mjaft të gjerë në gëzimin e të gjitha të drejtave të tjera. Kur respektohet e drejta e mendimit dhe shprehjes së tij, qeveritë bëhen më të përgjegjshme, politikat publike hartohen në mënyrë më të efektshme dhe dëgjohet zëri i popullit.
- Kritikkat ndaj kombit dhe simboleve të tij, qeverisë, anëtarëve dhe veprimtarisë së saj, nuk duhen konsideruar në asnjë lloj rrethane si vepër penale. Zyrtarët e zgjedhur dhe autoritetet duhet të pranojnë faktin se për shkak të rolit të tyre të spikatur dhe publik, bëhen objekt i një shkalle joproporcionale vëzhgimi nga media e shkruar.
- Monopolet apo përqendrimet e tepruara të pronësisë së medias, në duart e disa personave, duhet të shmangen në interes të zhvillimit të pluralizmit të pikëpamjeve dhe opinionëve;
- Mediat me pronësi shtetërore duhet të kenë përgjegjësinë e raportimit për të gjitha aspektet e jetës kombëtare dhe të ofrimit të aksesit në një gamë të larmishme pikëpamjesh; mediat me pronësi shtetërore nuk duhet të përdoren si organe komunikimi apo propagande për një parti politike apo si avokate të qeverisë për përjashtimin e të gjitha partive apo grupeve të tjera;
- Në periudhat parazgjedhore dhe në interes të garantimit të një elektorati sa më të informuar, shteti duhet të marrë masa që medias t'i jepet hapësira më e gjerë e mundshme. Mënyra më e mirë për ta arritur këtë është, mes të tjerash, informimi nga ana e medias i publikut rreth partive politike, kandidatëve, çështjeve të fushatës dhe proceseve zgjedhore; balancimi i paanshmërisë së medias qeveritare në raportimin e zgjedhjeve, pa diskriminuar asnjë parti politike apo kandidat në dhënien e kohës së transmetimit dhe garantimi që lajmet, intervistat dhe programet informative të mos jenë të njëanshme, pro apo kundër partive apo kandidatëve të caktuar;
- Ndalohej censura në çdo program për zgjedhjet dhe mediat inkurajohen të transmetojnë/publikojnë programet zgjedhore dhe nuk penalizohen për programet që kritikojnë qeverinë, politikat e saj apo partinë në pushtet;
- Media është e përjashtuar nga përgjegjësia ligjore për deklaratat provokuese të kandidatëve apo përfaqësuesve të partive; në rastet kur pretendohet për shpifje, parashikohet e drejta e përgënjeshtimit dhe e drejta e korigjimit apo tërheqjes; mënyra dhe shkalla e vënies në vend të së drejtës së cenuar duhet të përcaktohet nga një organ i pavarur;

6 Kjo pjesë paraqet parimet kryesore, që burojnë nga raportet e përvitshme për vitet 1999 deri 2009.

- Ekziston një dallim i qartë midis lajmeve dhe konferencave për shtyp në lidhje me funksionet zyrtare dhe aktivitetet e anëtarëve të qeverisë, sidomos kur anëtarë në fjalë është kandidat në zgjedhje;
- Koha e transmetimit për programe me akses të drejtpërdrejtë duhet të jepet në baza të drejta dhe jodiskriminuese; koha që u jepet partive dhe kandidatëve duhet të jetë e mjaftueshme që ata të komunikojnë mesazhet e tyre, që zgjedhësit të informohen rreth çështjeve të ndryshme, qëndrimeve të partive, si dhe kualifikimeve dhe karaktereve të kandidatëve;
- Programet duhet t'u ofrojnë një mundësi të efektshme gazetarëve, ekspertëve për çështje të aktualitetit dhe/ose publikut në përgjithësi, që ata të mund t'u drejtojnë pyetje drejtuesve të partive dhe kandidatëve të tjerë, si dhe t'u japin mundësinë kandidatëve për të debatuar;
- Media, sidomos media qeveritare, duhet të angazhohet në edukimin e zgjedhësve, duke ofruar edhe informacion mbi procesin e votimit, kur dhe ku duhet votuar, si bëhet regjistrimi për të votuar dhe si verifikohet nëse regjistrimi është bërë si duhet, informacionin për fshehtësinë e votës, rëndësinë e votimit, funksionet e zyrtarëve kandidatë dhe mbi çështje të tjera; dhe
- Media e shkruar dhe ajo elektronike duhet të prodhojnë raportime dhe programe që arrijnë numrin më të madh të mundshëm të zgjedhësve, duke përfshirë raportime dhe programe në gjuhët e pakicave, edhe për ata që mund të kenë qenë tradicionalisht të përjashtuar nga procesi politik, si: pakicat etnike ose fetare, gratë dhe grupet indigjene.
- Çdo mekanizëm apo organ rregullator, qoftë për median elektronike apo atë të shkruar, duhet të jetë i pavarur nga partitë politike dhe autonom në raport me qeverinë.

◆ **Deklaratë e Përbashkët, e vitit 2002 – Raportuesi i Posaçëm i OKB-së për Lirinë e Mendimit dhe Shprehjes, Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias, Raportuesi i Posaçëm i Organizatës së Shteteve Amerikane (OASH) për Lirinë e Shprehjes**

- Media e lirë dhe një gjyqësor i efektshëm luajnë një rol për forcimin e ndërsjellë të tyre në demokraci;
- Përdorimi i legjislacionit penal ndaj shpifjes, duke përfshirë edhe shpërdorimin e tij nga politikanët dhe figura të tjera publike, është i patolerueshëm. Legjislacioni penal për shpifjen duhet të shfuqizohet dhe të zëvendësohet me legjislacion civil, të përshtatshme për shpifjen;
- Shpërdorimi i financave publike nga qeveritë dhe institucionet publike, me qëllim ndikimin në përmbajtjen e medias, është i papranueshëm;
- Është përgjegjësi e pronarëve të medias që të respektojnë të drejtën e lirisë së shprehjes dhe pavarësinë editoriale të gazetarëve në veçanti;

- Nxitja e larmisë, duke përfshirë barazinë gjinore dhe mundësitë e barabarta për të gjitha shtresat e shoqërisë për akses në valët e transmetimit, është qëllimi kryesor i rregulloreve të transmetimeve;
- Rregullatorët e transmetuesve dhe organet drejtuese duhet të mbrohen nga ndërhyrjet politike dhe për qëllime tregtare;
- Përqendrimi i tepruar i pronësisë së medias duhet të parandalohet përmes masave të përshtatshme;
- Duhet të ketë një ndarje të aktiviteteve politike nga interesat mediatike të politikanëve dhe anëtarëve të qeverisë, që zotërojnë një organ mediatik.

♦ **Deklaratë e përbashkët për median dhe zgjedhjet, e vitit 2009 – Raportuesi i Posaçëm i OKB-së për Lirinë e Mendimit dhe Shprehjes, Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias, Raportuesi i Posaçëm i OASH-së për Lirinë e Shprehjes dhe Përfaqësuesi i Posaçëm i Komisionit Afrikan për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve për lirinë e shprehjes dhe aksesin në informacion**

(...) dalin me këtë Deklaratë për Mediat dhe Zgjedhjet:

***Mjedisi i përgjithshëm për median dhe zgjedhjet***

- Shtetet duhet të marrin një sërë masash, duke përfshirë edhe ato që theksohen në Deklaratën tonë të Përbashkët të datës 12 dhjetor 2007, për të krijuar një mjedis ku të mund të lulëzojë media pluraliste. Këto duhet të përfshijnë, mes të tjerash, detyrimin për transparencën e pronësisë së medias, licencimin e llojeve të ndryshme të transmetuesve për të nxitur larminë, rregulla për parandalimin e përqendrimit të tepruar të pronësisë së medias dhe masat për të nxitur larminë në përmbajtje mes organeve të ndryshme të medias dhe në secilën prej tyre.
- Ligjet që e kufizojnë padrejtësisht lirinë e shprehjes, në kundërshtim me garantitë ndërkombëtare dhe kushtetuese, duhet të shfuqizohen. Në ato vende ku këto ligje janë ende në fuqi, gjatë fushatave zgjedhore, autoritetet duhet të zbatojnë garantitë kushtetuese dhe ndërkombëtare, që mbrojnë lirinë e shprehjes.
- Shtetet duhet të ngrenë sisteme të efektshme për të parandaluar kërcënimet dhe sulmet ndaj medias dhe atyre që ushtrojnë të drejtën e tyre të lirisë së shprehjes, si dhe për t'i hetuar ato kur ndodhin, duke i vënë përgjegjësit para drejtësisë dhe duke dëmtshpërblyer të dëmtuarit. Ky detyrim merr një rëndësi të veçantë gjatë periudhave zgjedhore.
- Media duhet të jetë e lirë të raportojë mbi çështjet që lidhen me zgjedhjet. Ato duhet, gjithashtu, të përjashtohen nga përgjegjësia për shpërndarjen e deklaratave të paligjshme, të bëra drejtpërdrejt nga partitë apo kandidatët, qoftë në kontekstin e transmetimit drejtpërdrejt, qoftë në atë të reklamave, me përjashtim të rasteve kur gjykata i ka shpallur si të paligjshme, ose kur këto deklarata përbëjnë nxitje të drejtpërdrejtë të dhunës dhe kur media e ka pasur mundësinë të mos i shpërndajë.



- Detyrimi i figurave politike, duke përfshirë edhe kandidatët, për të toleruar një shkallë më të madhe kritike sesa personat e zakonshëm duhet të rikonfirmohet qartë, gjatë zgjedhjeve.
- Një parti apo kandidat, ndaj të cilës apo të cilit është shpifur në mënyrë të paligjshme apo që ka qenë objekt i një dëmi të paligjshëm nga një deklaratë në media gjatë periudhës zgjedhore, duhet të ketë të drejtën e përgënjeshtimit të shpejtë të asaj deklaratë ose të ketë të drejtën të kërkojë zgjidhje në gjykatën kompetente.
- Duhet të ndalohet me ligj diskriminimi nga ana e medias, në bazë të opinionëve politike apo shkaqeve të tjera të njohura, në shpërndarjen apo faturimin e reklamave politike me pagesë, në rastet kur këto lejohen me ligj.
- Mbikëqyrja e çdo rregulli që lidhet me median dhe me zgjedhjet, duhet t'i ngarkohet një organi të pavarur administrativ, i cili duhet të trajtojë menjëherë çdo ankesë. Vendimet e këtij organi duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor.

### **Media Publike**

Të gjitha mediat në pronësi publike, duke përfshirë transmetuesit publikë, duhet të jenë objekt i detyrimeve të mëposhtme, gjatë periudhave zgjedhore:

- Garantimi i informimit të elektoratit rreth çështjeve zgjedhore, duke përfshirë rolin e zgjedhësve në demokraci, mënyrën e ushtrimit të së drejtës për të votuar, çështjet kryesore zgjedhore, dhe qëndrimet e partive dhe kandidatëve të ndryshëm, që kontestojnë zgjedhjet. Normalisht, këtu duhet të përfshihet raportimi që përfshin pyetjet që u bëhen drejtuesve të partive politike dhe kandidatëve, si dhe debatet e kandidatëve.
- Respektimi i rregullave rigorozë për paanshmërinë dhe balancimin, veçanërisht kur raportohet mbi partinë apo partitë në pushtet dhe mbi vendimet e masave të qeverisë gjatë periudhave zgjedhore. Kjo nënkupton që duhet t'u jepet mbulim i barabartë argumenteve pro të të dyja palëve, në çdo referendum.
- Garantimi i aksesit të barabartë të gjitha partive dhe kandidatëve në media që t'i komunikojnë publikut mesazhet e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë, qoftë falas apo me tarifa të subvencionuara. Akses i barabartë do të thotë akses i drejtë dhe jodiskriminues, që caktohet sipas kriterëve objektive për matjen e niveleve të përgjithshme të mbështetjes, që përfshijnë faktorë, si: kohëzgjatja e aksesit dhe çdo tarifë e aplikuar.
- Garantimi i shoqërimit të çdo raportimi për sondazhe apo parashikime të zgjedhjeve, me informacione të mjaftueshme, për t'i dhënë mundësi zgjedhësve të kuptojnë si duhet domethënien e tyre.

### ♦ **KiE: Rekomandim CM/Rec(2007)15 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për masat në lidhje me mbulimin mediatik të fushatave zgjedhore, i vitit 2007**

#### *Parimet*

i. Dispozita të përgjithshme

#### 1. Mosndërhyrja nga autoritetet publike

Autoritetet publike nuk duhet të ndërhyjnë në aktivitetet e gazetarëve dhe punonjësve të tjerë të medias, për të ndikuar tek zgjedhjet.

#### 2. Mbrojtja nga sulmet, frikësimet dhe llojet e tjera të presioneve të jashtëligjshme mbi median

Autoritetet publike duhet të marrin hapat e nevojshëm për mbrojtjen e efektshme të gazetarëve dhe punonjësve të tjerë të medias dhe mjediseve të tyre, sidomos gjatë zgjedhjeve. Në të njëjtën kohë, kjo mbrojtje nuk duhet të pengojë median në kryerjen e punës së saj.

#### 3. Pavarësia editoriale

Kuadri rregullator për pasqyrimin nga media të zgjedhjeve, duhet të respektojë pavarësinë editoriale të medias. Shtetet anëtare duhet të kujdesen që të kenë një ndarje të efektshme dhe të dukshme midis ushtrimit të kontrollit të medias dhe vendimmarrjes sa i përket përmbajtjes së medias, si dhe ushtrimit të autoritetit apo ndikimit politik.

#### 4. Pronësia nga autoritetet publike

Shtetet anëtare duhet të marrin masa, përmes të cilave mediat në pronësi të autoriteteve publike, në rastin e zgjedhjeve, t'i mbulojnë ato në mënyrë të barabartë, të balancuar dhe të paanshme, pa diskriminuar dhe pa mbështetur parti apo kandidatë të caktuar politikë. Nëse këto media pranojnë reklama politike, të paguara për publikim, ato duhet të kujdesen që të gjithë konkurrentët dhe partitë politike, që kërkojnë blerjen e hapësirave reklamuese, të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese.

#### 5. Standardet profesionale dhe etike të medias

Të gjitha mediat duhet të inkurajohen të hartojnë kuadro vetërregulluese dhe të përfshijnë në to, standarde vetërregulluese profesionale dhe etike në lidhje me pasqyrimin prej tyre të fushatave zgjedhore, duke përfshirë, mes të tjerash, respektimin e dinjitetit njerëzor dhe mosdiskriminimin. Këto standarde duhet të pasqyrojnë rolet dhe përgjegjësitë e tyre në proceset demokratike.

#### 6. Transparenca e medias dhe aksesit në të

Nëse media pranon reklama politike me pagesë, kuadrot rregullatore ose vetërregullatore duhet të sigurojnë që këto reklama të jenë lehtësisht të dallueshme si të tilla. Në rastet kur media është në pronësi të partive politike apo politikanëve, shtetet anëtare duhet të marrin masa që kjo gjë të bëhet transparente për publikun.

## 7. E drejta e replikës ose zgjidhjeve ligjore të barasvlershme

Duke pasur parasysh kohëzgjatjen e një fushate zgjedhore, çdo kandidat apo parti politike që ka të drejtën e replikës apo të zgjidhjeve ligjore të barasvlershme sipas ligjit apo sistemit vendas, duhet të jetë në gjendje ta ushtrojë këtë të drejtë apo këto zgjidhje ligjore të barasvlershme gjatë periudhës së fushatës, pa vonesa të panevojshme.

## 8. Sondazhet

Kuadrot rregullatore ose vetërregullatore duhet të garantojnë që, në dhënien e rezultateve të sondazheve, media t'i ofrojë publikut informacion të mjaftueshëm, që ai të gjykojë vlerën e sondazheve. Në veçanti, ky informacion mundet:

- të përmbajë emrin e partisë politike, organizatave apo personave që e kanë porositur sondazhin dhe që kanë paguar për realizimin e tij;
- të identifikojë organizatën që e ka realizuar sondazhin dhe metodologjinë e përdorur;
- të përshkruajë kampionin dhe marzhin e gabimit të sondazhit;
- të tregojë datën dhe/ose periudhën e kryerjes së sondazhit.

Të gjitha çështjet e tjera, që lidhen me mënyrën e paraqitjes mediatike të rezultateve të sondazheve, duhet të vendosen nga vetë media. Çdo kufizim nga shtetet anëtare, që ndalon publikimin/transmetimin e sondazheve (për qëllime votimi) në ditën e zgjedhjeve apo disa ditë para zgjedhjeve, duhet të jetë në përputhje me nenin 10 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, siç interpretohet nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Po kështu, sa u përket exitpoll-eve, shtetet anëtare mund të marrin në konsideratë ndalimin e dhënies së rezultateve të këtyre sondazheve nga media, deri në momentin e mbylljes së të gjitha qendrave të votimit në vend.

## 9. "Dita e reflektimit" (Heshtja zgjedhore)

Shtetet anëtare mund të shqyrtojnë avantazhet e miratimit të një dispozite në kuadrin e tyre rregullator, që ndalon shpërndarjen e mesazheve zgjedhore të njëanshme në ditën para votimit apo që parashikon korrigjimin e tyre.

## ***II. Masat në lidhje me median transmetuese (media audiovizive)***

### 1. Kuadri i përgjithshëm

Gjatë fushatave zgjedhore, kuadri rregullator duhet të inkurajojë dhe lehtësojë shprehjen pluraliste të pikëpamjeve mes mediave transmetuese. Sa i përket pavarësisë editoriale të transmetuesve, kuadri rregullator duhet gjithashtu të parashikojë detyrimin e pasqyrit të fushatave zgjedhore në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshme, në shërbimet e përgjithshme programative të transmetuesve. Ky detyrim duhet të zbatohet si për mediat publike, ashtu edhe për transmetuesit privatë në fushat e tyre të transmetimit. Shtetet anëtare mund t'u lejojnë devijimin nga këto masa, shërbimeve të mediave transmetuese, që i kushtohen në mënyrë ekskluzive dhe që identifikohen qartë si vetëpromovuese të një partie politike apo të një kandidati.

## 2. Edicionet informative dhe programet e aktualitetit

Në rastet kur vetërregullimi nuk e parashikon, shtetet anëtare duhet të marrin masa, përmes të cilave mediat publike dhe transmetuesit privatë duhet të jenë veçanërisht të ndershëm, të balancuar dhe të paanshëm në edicionet e tyre informative dhe në programet e aktualitetit gjatë periudhave zgjedhore, duke përfshirë programet e diskutimeve, si p.sh.: intervistat apo debatet. Gjatë këtyre programeve, nuk duhet lejuar asnjë lloj trajtimi i privilegjuar nga transmetuesit apo autoritetet publike. Kjo çështje duhet të sanksionohet së pari përmes masave të duhura vetërregulluese. Në këtë aspekt, shtetet anëtare mund të shohin nëse autoriteteve përkatëse, që monitorojnë pasqyrimin e zgjedhjeve, duhet t'i jepet kompetenca për të ndërhyrë me qëllim korrigjimin e mangësive të mundshme, në rastet ku kjo ndërhyrje është praktikisht e realizueshme.

## 3. Shërbimet audiovizive jolineare të medias publike

Shtetet anëtare duhet të zbatojnë parimet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 më sipër, ose dispozita të ngjashme, për shërbimet audiovizive jolineare të medias publike.

## 4. Koha e transmetimit falas dhe prania ekuivalente e partive politike/kandidatëve në mediat publike.

Shtetet anëtare mund të shqyrtojnë mundësinë që të përfshijnë në kuadrin rregullator, dispozita që mediat publike, gjatë periudhave zgjedhore, të vënë në dispozicion të partive/kandidatëve politikë, kohë transmetimi falas në transmetimet audiovizive lineare dhe/ose prani të barasvlershme në transmetimet audiovizive jolineare. Në të gjitha rastet kur jepet kohë transmetimi falas, kjo duhet të bëhet në mënyrë të ndershme, jodiskriminuese dhe mbi baza e kriteret transparente dhe objektive.

## 5. Reklamat politike me pagesë

Në shtetet anëtare ku partive politike dhe kandidatëve u lejohej të blejnë hapësirë reklamuese për qëllime zgjedhore, kuadri rregullator duhet të kujdeset që të gjitha partive garuese t'u jepet mundësia e blerjes së hapësirës reklamuese sipas kushteve dhe tarifave të barabarta. Shtetet anëtare mund të konsiderojnë miratimin e një dispozite në kuadrin e tyre rregullator, për të kufizuar sasinë e hapësirës së reklamave politike dhe të kohës që mund të blejë një parti apo një kandidat i caktuar. Prezantuesit e zakonshëm të lajmeve dhe programeve të aktualitetit nuk duhet të marrin pjesë në reklamat politike me pagesë.

### ♦ **Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës: Rezoluta 1636 (2008) Treguesit e medias në demokraci**

1. Asambleja Parlamentare rithekson rëndësinë e lirisë së medias. Liria e shprehjes dhe informimit në media është një kërkesë e domosdoshme e demokracisë. Pjesëmarrja publike në proceset demokratike të vendimmarrjes kërkon që publiku të mirinformohet dhe të ketë mundësinë të diskutojë lirisht pikëpamjet e ndryshme.

(...)

7. Asambleja e konsideron të nevojshëm respektimin e një sërë parimesh në lidhje me lirinë e medias në shoqëritë demokratike. Një listë e këtyre parimeve do të lehtësonte analizimin e mjediseve kombëtare të medias sa i përket lirisë së medias, gjë që mund të identifikonte çështjet problematike dhe mangësitë e mundshme. Kjo do t'u jepte mundësi shteteve anëtare të diskutonin në nivel evropian, hapat që mund të marrin për trajtimin e këtyre problemeve.

8. Asambleja fton parlamentet kombëtare ta analizojnë rregullisht situatën e tyre të medias, në mënyrë objektive dhe të krahasueshme, në mënyrë që të jenë në gjendje të identifikojnë mangësitë në legjislacionin dhe praktikën vendase të medias dhe të marrin masat e nevojshme për zgjidhjen e tyre. Këto analiza duhet të mbështeten në këtë listë parimesh bazë:

8.1. e drejta e lirisë së shprehjes dhe informimit përmes medias duhet të garantohet nga legjislacioni i brendshëm dhe kjo e drejtë duhet të jetë e zbatueshme. Numri i lartë i çështjeve gjyqësore në lidhje me këtë të drejtë është tregues i problemeve me zbatimin e legjislacionit të brendshëm për median dhe kërkon rishikimin e legjislacionit ose praktikës;

8.2. zyrtarët shtetërorë nuk duhet të gëzojnë mbrojtje nga kritika dhe shpifja në shkallë më të madhe sesa njerëzit e zakonshëm, për shembull, përmes ligjeve penale që parashikojnë dënime më të forta. Gazetarët nuk duhet të burgosen dhe organet e mediave nuk duhet të mbyllën për shkak të komenteve kritike;

8.3. ligjet penale kundër nxitjes së urrejtjes apo për mbrojtjen e rendit publik apo sigurisë kombëtare duhet të respektojnë lirinë e shprehjes. Nëse vendosen dënime, ato duhet të respektojnë kriterin e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit. Nëse nisur nga shpeshtësia dhe intensiteti i dënimeve të marra mund të mendohet se zbatimi i këtyre ligjeve ka motive politike, atëherë legjislacioni dhe praktika e medias duhet të ndryshohen;

8.4. gazetarët nuk duhet t'u nënshtrohen kriterëve të panevojshme nga shteti, para se të mund të punojnë;

8.5. partitë politike dhe kandidatët duhet të kenë akses të barabartë dhe të drejtë në media. Aksesit i tyre në media duhet të lehtësohet gjatë fushatave zgjedhore;

(...)

8.9. të drejtat ekskluzive të raportimit në lidhje me ngjarje madhore me interes publik nuk duhet të ndërhyjnë në të drejtën e publikut për lirinë e informimit;

8.10. ligjet për jetën private dhe sigurinë shtetërore nuk duhet të kufizojnë më shumë sesa duhet informimin; (...)

8.13. organet e medias duhet të kenë pavarësi editoriale nga pronarët e medias, për shembull, duke rënë dakord me pronarët për kode etike mbi pavarësinë editoriale, për të garantuar mosndërrhyrjen e pronarëve të medias në punën e përditshme editoriale apo për të mos lejuar komprometimin e gazetarisë së paanshme;

8.14. gazetarët duhet të mbrohen nga kërcënimet dhe sulmet fizike, që mund të vijnë për shkak të punës së tyre. Në rastet kur gazetarët që ndihen të kërcënuar, kërkojnë mbrojtje nga policia, kjo mbrojtje duhet t'u ofrohet. Prokuroria dhe gjykata duhet t'i trajtojnë siç duhet dhe në kohë, rastet e kërcënimit apo sulmit ndaj gazetarëve;

(...)

8.18. pronësia e medias dhe ndikimet ekonomike në media duhet të bëhen transparente. Duhet të zbatohet ligji kundër monopoleve dhe pozitive dominuese në treg mes mediave të ndryshme. Përveç kësaj, duhet të merren hapa pozitivë konkretë për nxitjen e pluralizmit në media;

8.19. nëse mediat marrin subvencione të drejtpërdrejta apo të tërthorta, shtetet duhet t'i trajtojnë ato media në mënyrë të drejtë dhe neutrale;

8.20. transmetuesit publikë duhet të mbrohen nga ndërhyrjet politike në administrimin dhe punën e tyre të përditshme editoriale. Personat me përkatësi të qartë politike nuk duhet të caktohen në poste të larta drejtuese;

8.21. transmetuesit publikë duhet të hartojnë kodet e tyre të brendshme të etikës për punën gazetareske dhe pavarësinë editoriale nga kahet politike;

8.22. media "private" nuk duhet të menaxhohet apo mbahet nga kompani shtetërore apo kompani të kontrolluara nga shteti;

8.23. anëtarët e qeverisë nuk duhet të vazhdojnë aktivitetet e tyre mediatike profesionale gjatë kohës që janë në qeveri;

8.24. qeveria, parlamenti dhe gjykatat duhet të jenë të hapura ndaj medias në mënyrë të drejtë dhe të barabartë;

8.25. duhet të ketë një sistem vetërregullimi të medias që përfshin të drejtën e replikës dhe korrigjimit ose ndjesës vullnetare nga gazetarët. Media duhet të ngrrejë organet e veta vetërregulluese, si komisionet e ankesave apo ombudsmanët e medias dhe vendimet e këtyre organeve duhet të gjejnë zbatim. Këto masa duhet të njihen ligjërisht nga gjykatat;

8.26. gazetarët duhet të hartojnë kodet e tyre profesionale të etikës, të cilat duhet të zbatohen. Ata duhet t'i bëjnë të ditur shikuesve ose lexuesve, çdo interes politik apo financiar, si dhe çdo bashkëpunim me organet shtetërore, si për shembull gazetaria me anshmëri ushtarake; (...)

#### ◆ **KiE: Deklaratë e Komitetit të Ministrave për lirinë e debatit politik në media, e vitit 2004**

##### *1. Liria e shprehjes dhe e informimit mes medias*

Demokracia pluraliste dhe liria e debatit politik kërkojnë që publiku të informohet reth çështjeve me interes publik, që përfshin të drejtën e medias për të përhapur

informacione negative dhe opinione kritike në lidhje me figurat politike dhe zyrtarët publikë, si dhe të drejtën e publikut për t'i marrë ato

## ***II. Liria për të kritikuar qeverinë ose institucionet publike***

Shteti, qeveria apo çdo institucion tjetër i ekzekutivit, legjislativit apo gjyqësorit mund të jenë objekt i kritikës në media. Për shkak të pozicionit të tyre dominues në media, ligji penal nuk duhet t'i mbrojtë këto institucione ndaj deklaratave fyese apo shpifëse. Megjithatë, në rastet kur këto institucione e gëzojnë një mbrojtje të tillë, ajo duhet të zbatohet në mënyrë kufizuese, duke shmangur në çdo rrethanë përdorimin e saj për të kufizuar lirinë për të kritikuar. Individët që përfaqësojnë këto institucione vazhdojnë të gëzojnë mbrojtje si individë.

## ***III. Debati publik dhe vëzhgimi i figurave politike***

Figurat politike kanë vendosur të fitojnë besimin e publikut dhe kanë pranuar t'i nënshtrohen debateve politike publike dhe për këtë arsye janë objekt i vëzhgimit kritik nga ana e publikut dhe ndoshta edhe i kritikave të forta dhe të ashpra publike përmes medias, në lidhje me mënyrën si i kanë ushtruar funksionet e tyre.

## ***IV. Vëzhgimi kritik i zyrtarëve publikë nga ana e publikut***

Zyrtarët publikë duhet të pranojnë se do të jenë objekt i vëzhgimit dhe kritikave të publikut, sidomos përmes medias, për mënyrën se si i kanë ushtruar ose si i ushtrojnë funksionet e tyre, për aq sa kjo nevojitet për garantimin e transparencës dhe ushtrimit të përgjegjshëm të funksioneve të tyre.

## ***V. Liria e satirës***

Zhanri humoristik dhe satirik, siç mbrohet nga neni 10 i Konventës, lejon një shkallë më të madhe ekzagjerimi e madje edhe provokimi, për sa kohë nuk e çon publikun drejt keqinterpretimit të fakteve.

## ***VI. Reputacioni i figurave politike dhe zyrtarëve publikë***

Në lidhje me reputacionin, figurat politike nuk duhet të gëzojnë më shumë mbrojtje dhe më shumë të drejta sesa individë të tjerë, kështu që legjislativi i brendshëm nuk duhet të parashikojë sanksione më të rrepta për median, për kritikën e kësaj të fundit ndaj figurave politike. Ky parim vlen edhe për zyrtarët publikë; devijimet duhet të lejohen vetëm në rastet kur ato janë patjetër të nevojshme për t'u dhënë mundësi zyrtarëve publikë t'i ushtrojnë siç duhet funksionet e tyre.

## ***VII. Jeta private e figurave politike dhe zyrtarëve publikë***

Jeta private dhe jeta familjare e figurave politike dhe zyrtarëve publikë duhet të mbrohet nga raportimi mediatik sipas nenit 8 të Konventës. Megjithatë, mund të transmetohen informacione rreth jetës së tyre private kur ato përbëjnë drejtpërdrejt interes publik, sa i përket mënyrës se si ata kanë ushtruar apo ushtrojnë funksionet e tyre, duke pasur parasysh njëkohësisht nevojën e shmangies së dëmeve të panevojshme ndaj palëve të

treta. Në rastet kur figurat politike dhe zyrtarët publikë tërheqin vëmendjen e publikut ndaj pjesëve të jetës së tyre private, media ka të drejtë t'i bëjë ato pjesë, objekt vëzhgimi.

### **VIII. Zgjidhjet ligjore ndaj shkeljeve të medias**

Në rastin e shkeljes së të drejtave të tyre nga media, figurat politike dhe zyrtarët publikë duhet të kenë akses vetëm në ato zgjidhje ligjore ndaj medias, që kanë edhe qytetarët si individë. Kompensimet dhe gjobat për rastet e shpifjes apo fyerjes duhet të jenë në raport të drejtë me shkeljen e të drejtave apo reputacionit të të tjerëve, duke marrë parasysh çdo zgjidhje të mundshme të efektshme dhe të përshtatshme, të ofruar nga media dhe të pranuar nga personat në fjalë. Shpifja dhe fyerja nga media nuk duhet të çojë në burgim, me përjashtim të rasteve kur shkalla e shkeljes së të drejtave apo reputacionit të të tjerëve, e bëjnë atë një penalitet të domosdoshëm dhe proporcional, sidomos atëherë kur të drejtat e tjera themelore shkelen rëndë nga deklaratimet shpifëse apo fyese në media, siç është gjuha e urrejtjes.

### **◆ Komisioni i Venecias: Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, i vitit 2002**

#### ***Klauzola 2.3. Barazia e shanceve***

a. Shancet e barabarta duhet të garantohen si për partitë, ashtu dhe për kandidatët. Kjo i detyron autoritetet shtetërore të kenë një qëndrim asnjansës, sa i takon:

i. fushatës zgjedhore;

ii. pasqyrimin nga media, veçanërisht nga media publike;

iii. financimeve publike të partive dhe fushatave.

b. Në varësi të objektit, barazia mund të jetë rigorozë ose proporcionale. Në rast se është rigorozë, partitë politike trajtohen në mënyrë të barabartë pavarësisht nga fuqia e tyre parlamentare aktuale ose mbështetja nga elektorati. Në rast se është proporcionale, partitë politike duhet të trajtohen në bazë të rezultateve të arritura në zgjedhje. Parimi i shanceve të barabarta zbatohet në veçanti për kohën e pasqyrimin të fushatës zgjedhore nga radio dhe televizioni, financimet publike dhe format e tjera të mbështetjes.

c. Në përputhje me lirinë e shprehjes, duhen miratuar dispozita ligjore për të siguruar që të gjithë pjesëmarrësit në zgjedhje të kenë pasqyrimin minimal të fushatave dhe reklamave të tyre elektorale në mediat audiovizive private.

d. Financimet e partive politike, kandidatëve dhe fushatës zgjedhore duhet të jenë transparente.

e. Në raste të caktuara, parimi i shanceve të barabarta mund të çojë në një kufizim të shpenzimeve për partitë politike, veçanërisht sa u përket reklamave.

#### ***Klauzola 3 Votimi i lirë***

3.1. Liria e zgjedhësve për të formuar opinionin e tyre.



a. Autoritetet shtetërore duhet të jenë të paanshme. Në veçanti, kjo ka të bëjë me:

i. median;

(...)

## Parimet e deklaruara nga GJEDNJ-ja

### ◆ Parimet kryesore<sup>7</sup>

- Censura paraprake përbën kufizim të papranueshëm të së drejtës së lirisë së shprehjes dhe ligji duhet të parashikojë kufizime të kësaj të drejte vetëm në rrethana përjashtuese.<sup>8</sup>
- Liria e medias përbën parakusht themelor për lirinë e shprehjes. Media e shkruar e bashkë me të edhe media elektronike, kanë detyrimin e dyfishtë “të japin informacion dhe ide për çështje të interesit publik. Jo vetëm që e kanë për detyrë të japin informacion dhe ide, por edhe publiku ka të drejtë t’i marrë ato. Nëse do të ishte ndryshe, do të ishte e pamundur që shtypi të luante rolin e tij jetësor të monitoruesit publik.”<sup>9</sup>
- E drejta e lirisë së shprehjes përfshin lirinë e debatit politik, ekzistenca e të cilit qëndron “në themel të konceptit të shoqërisë demokratike”.<sup>10</sup>
- Kufijtë e kritikës ndaj politikanëve dhe përfaqësuesve të qeverisë janë më të gjerë sesa ato të qytetarëve si individë.<sup>11</sup>
- Duhet të ketë mbrojtje më të madhe për opinionet politike, vërtetësia e të cilave, ndryshe nga faktet, nuk mund të provohet apo të rrëzohet.<sup>12</sup>

7 Kjo pjesë paraqet parimet kryesore të praktikës gjyqësore së GJEDNJ-së. Referencat korresponduese të praktikës gjyqësore jepen në shënimet përkatëse në fund të faqes.

8 Gjykata Evropiane e Drejtave të Njeriut ka theksuar se “Shtetet kontraktuese gëzojnë një marzh të caktuar diskrecioni në vlerësimin e nevojës për ndërhyrje, por ky marzh shkon paralelisht me mbikëqyrjen evropiane, shtrirja e së cilës varion sipas rastit. Aty ku ka pasur ndërhyrje për garantimin e ushtrimit të të drejtave dhe lirisë në paragrafin 1 të nenit 10, mbikëqyrja duhet të jetë rigorozë, për shkak të rëndësisë së të drejtës në fjalë; rëndësia e këtyre të drejtave është theksuar nga Gjykata shumë herë. Nevoja për kufizimin e tyre duhet të shprehet në mënyrë bindëse.” Autronic AG kundër Zvicrës, vendim i datës 22 maj 1990.

9 “Lingens kundër Austrisë”, vendim gjyqësor i datës 8 korrik 1986. “Thorgeir Thorgeirson kundër Islandës”, vendim gjyqësor i datës 25 qershor 1992.

10 “Castells kundër Spanjës”, vendim gjyqësor i datës 23 prill 1992.

11 “Lingens kundër Austrisë”, vep. cit., shënimi 9. “Kufijtë e kritikës së pranueshme në rastin e një politikani janë më të gjera sesa në rastin e një individi. Ndryshe nga individi, politikani hapet në mënyrë të pashmangshme dhe të vetëdijshme ndaj monitorimit të imët nga gazetarët për çdo fjalë që thotë apo veprim që bën, ashtu edhe nga publiku në përgjithësi dhe për rrjedhojë, duhet të demonstrojë shkallë tolerance më të madhe.”

12 Po aty. “Ekzistenca e fakteve mund të demonstron, kurse vërtetësia e gjykimeve nuk i nënshtrohet provave.”

- Media e ka për detyrë t'i publikojë pikëpamjet e kundërta, duke respektuar në të njëjtën kohë kriteret e balancimit dhe mosdiskriminimit.<sup>13</sup>
- Koha e caktuar për transmetime politike nuk është e pakufizuar dhe duhet të përcaktohen disa kriteret për shpërndarjen e drejtë të kohës së transmetimit. Këto kriteret duhet të aplikohen pa asnjë lloj arbitrariteti apo diskriminimi.<sup>14</sup>

#### ◆ Parimet kryesore<sup>15</sup>

- Koha e caktuar për transmetime politike nuk është e pakufizuar dhe duhet të vendosen kriteret për ndarjen e drejtë të saj. Këto kriteret duhet të zbatohen pa asnjë lloj arbitrariteti apo diskriminimi.<sup>16</sup>
- Liria e shprehjes është një nga 'kushtet' e nevojshme për garantimin e shprehjes së lirë të opinionëve të njerëzve në zgjedhjen e legjislaturës. Për këtë arsye, është veçanërisht e rëndësishme që në periudhën para zgjedhjeve të lejohet qarkullimi i lirë i të gjitha opinionëve dhe informacioneve të të gjitha llojeve.<sup>17</sup>
- Ndalimi i reklamave politike, të cilat zbatohen vetëm në rastin e mediave të caktuara (p.sh.: për mediat transmetuese dhe jo për median e shkruar) nuk duket të jetë gjithmonë kufizim i nevojshëm. Megjithatë, Gjykata nuk ka përjashtuar faktin që në raste të caktuara, moslejimi i "reklamave politike" mund të jetë në përputhje me kërkesat e nenit 10. Megjithatë, ndërhyrja në lirinë e shprehjes mund të justifikohet në "mënyrë të përshtatshme dhe të mjaftueshme".<sup>18</sup>
- Në vetvete, moslejimi i reklamave nuk përbën shkelje të nenit 10, duke qenë se qëllimi është të mos lejohet partitë e mëdha me shumë fonde që të marrin më shumë kohë transmetimi sesa partitë e tjera që nuk kanë fonde. Megjithatë, partitë të vogla me pasqyrim të vogël mediatik dhe që nuk u jepet kohë e rëndësishme transmetimi

13 X dhe Shoqata e Z kundër Mbretërisë së Bashkuar, Vendimi i Pranimit, i datës 12 korrik 1971, 38 Përmbledhje të Vendimeve 86 (1971). "... liria për të dhënë informacione dhe ide, që përfshihet në të drejtën e lirisë së shprehjes, të garantuar nga neni 10, nuk mund të interpretohet se përfshin një të drejtë të përgjithshme dhe të lirë që një organizatë e individëve privatë të ketë akses në kohë transmetimi në radio apo televizion për të shprehur pikëpamjet e saj. Megjithatë, ajo shprehet se mohimi i kohës transmetuese ndaj një apo më shumë grupeve të veçanta mundet që, në rrethana të veçanta, të përbëjë problem në kuadrin e nenit 10 (i marrë i veçuar ose i lidhur me nenin 14 që ndalon diskriminimin). Në parim, një problem i tillë mund të dalë nëse, për shembull, në kohën e zgjedhjeve, një parti politike është përjashtuar nga organet transmetuese, ndërkohë që partitë e tjera u është dhënë kohë transmetimi. Megjithatë, kjo kohë transmetimi mund t'i nënshtrohet disa kriterëve që përcaktohen nga shoqëria transmetuese, në kuadër të politikës së saj editoriale."

14 Huggett kundër Mbretërisë së Bashkuar (1995) 82A DR 98, vendim i Komisionit të GJEDNJ-së.

15 Kjo pjesë paraqet parimet kryesore që rrjedhin nga jurisprudenca e GJEDNJ-së. Referencat korresponduese të praktikës gjyqësore jepen në shënimet përkatëse në fund të faqes.

16 Huggett kundër Mbretërisë së Bashkuar, vep. cit., shënimi 14.

17 Bowman kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 19 shkurt 1998.

18 GT Shoqata kundër fabrikave të kafshëve kundër Zvicrës, vendim i datës 28 qershor 2001.

gjatë pasqyrit të zgjedhjeve, mund t'u lejojehet të transmetojnë reklama nëse nuk merret asnjë masë tjetër për t'u siguruar akses në median audiovizive.<sup>19</sup>

---

<sup>19</sup> "TV Vest As & Rogaland Pensjonistparti kundër Norvegjisë", vendim gjyqësor i datës 11 mars 2009.

Liria e shprehjes dhe liria e medias janë thelbësore për çdo proces demokratik dhe vlerësimi i mbulimit nga media të fushatave zgjedhore përbën një pjesë themelore të metodologjisë së vëzhgimit të zgjedhjeve. Ky botim ofron një shpjegim të përmbledhur të metodologjisë së monitorimit të medias, që përdoret nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), në veprimtaritë e saj për vëzhgimin e zgjedhjeve.

Ky manual përfshin një sërë udhëzimesh për mbulimin e fushatave zgjedhore nga mediat publike dhe private, sidomos mediat elektronike dhe ajo e shkruar, duke trajtuar edhe ato që lidhen me internetin dhe media të tjera të reja. Ky manual nuk ka për qëllim të ofrojë një katalog të hollësishëm të këtyre çështjeve, por të theksojë disa parime të përbashkëta, të cilat janë të rëndësishme për vëzhguesit ndërkombëtarë në vlerësimin e proceseve zgjedhore nga këndvështrimi i medias.

Ky botim përfshin edhe disa informacione bazë mbi aspektet teknike të monitorimit të medias, duke shpjeguar rolin e veçantë të analistit të medias në misionet e vëzhgimit të zgjedhjeve. Megjithatë, ky nuk është konceptuar si një manual teknik që detajon çdo aspekt të kësaj detyre.